



## Dëftues botimi

Botimi 2021

Kjo broshurë qëndron në:

- ▶ **shqip**
- ▶ arabisht
- ▶ dari/farsi
- ▶ gjermanisht
- ▶ anglisht
- ▶ italisht
- ▶ kurmanji
- ▶ polonisht
- ▶ portugalisht
- ▶ rumanisht
- ▶ serbokroatisht
- ▶ sllovakisht
- ▶ spanjisht
- ▶ tigrinia
- ▶ hungarisht



nën [www.migrationsamt.tg.ch/integration](http://www.migrationsamt.tg.ch/integration)  
në dispozicion për shkarkim.



### **Mirëseardhje e përzemërt!**

Ne gëzohemi, që ju keni ardhur të banoni në kantonin Thurgau.

Ju vendoseni në një kanton dinamik, i cili nga njëra anë është i hapur, por nga ana tjetër po ashtu i lidhur me institucionet dhe tradit-

tat e tij. Peizazhi i tij i pacenuar natyror, pozicioni i tij favorizues pranë liqenit Bodensee, ekonomia e tij aktive në degë të ndryshme dhe marrëdhëniet e tij intensive me kantonet fqinj Schaffhausen, Cyrih dhe St. Gallen si dhe me shtetet e afërta kufitare Gjermani dhe Austri e shndërrojnë Thurgau-n në një vend atraktiv banimi dhe pune. Ne shpresojmë që ju dhe familja juaj shpejt do të ndiheni mirë në kantonin tonë të bukur. Jeta shoqërore dhe topografia e shoqatave këtu janë të shumëllojshme. Ju jeni të ftuar përzemërsisht që të merrni pjesë atje.

Ne gëzohemi që mirëkuptimi ndërmjet grupeve të ndryshme të popullsisë është i mirë. Thurgau është një kanton paqësor, në të cilin takohen miqësisht njerëz të gjeneratave, kulturave dhe botëkuptime-

ve të ndryshme. Kjo nuk është e vetëkuptueshme, përkundrazi kërkon mundime përshtatjeje nga të dyja anët. Të gjithë janë të thirrur, që të jetojnë tolerancën dhe kujdesin ndaj bashkëqytetarëve – këto janë vlerat bazë të vendit tonë dhe të shoqërisë sonë.

Në këtë broshurë ju gjeni shumë informacione për jetën dhe për ofertat në kantonin tonë. Mësoni gjuhën lokale! Ajo është një çelës për pavarësinë dhe mëvetësinë tuaj. Ne ju bëjmë thirrje po ashtu për një të qeni së bashku me qytetarët dhe qytetarët e Thurgau-t. Përvoja juaj do t'ju ndihmojë juve, që të kuptoni më mirë ambientin e ri, të integrohni këtu dhe të ndiheni mirë.

Ne ju urojmë mirëseardhje të përzemërt dhe ju dëshirojmë shumë zbulime dhe takime interesante.

Cornelia Komposch

Kryetare e këshillit të qeverisë  
Departamenti i Drejtësisë dhe Sigurisë

<b>Bashkëjetesa në Thurgau.....</b>	<b>6</b>	Shkëmbimi i patentës Qarkullimi publik Bicikleta si dhe këmbësore e këmbësorë
Kantoni, qarqet, komunat Gjuha Integrimi Popullsia e huaj Politika e integritit Informacione në vend		
<b>Ardhja për të banuar në kanton .....</b>	<b>8</b>	
Lista kontrolli pas hyrjes		
<b>Të drejta dhe detyrime.....</b>	<b>10</b>	
Vlerat themelore Sovran Të drejtat dhe detyrimet Kufizimi i të drejtave Kërkesa gjuhësore		
<b>Komunikimi .....</b>	<b>12</b>	
Të mësuarit e gjermanishtes Të mësosh gjermanishten zvicerane Përkthimi ndërkulturor Biblioteka ndërkulturore		
<b>Banimi .....</b>	<b>14</b>	
Të gjendet një banesë Sigurim i sendeve shtëpiake dhe sigurim për përgjegjësinë ligjore Taksa për radio dhe televizor Jeta në një shtëpi me qira		
<b>Transporti.....</b>	<b>16</b>	
Veturat Importimi i automjeteve private		
		<b>18</b>
		Të gjendet një vend pune Rroga Mbrotjtja nga prishja e kontratës së punës Tatimet Tensione në vendin e punës Mosdiskriminimi Puna në të zezë
		<b>21</b>
		<b>Përkujdesje/sigurimet sociale.....</b>
		Sigurimi për papunësinë Ndhma sociale Kontribute të detyruara Përkujdesja: shtylla e 1-rë Përkujdesja: shtylla e 2-të Përkujdesja: shtylla e 3-të
		<b>24</b>
		<b>Shëndeti.....</b>
		Sigurimi shëndetësor dhe ndaj aksidenteve Mjeket dhe mjekët Përkrahja shëndetësore dhe parandalimi Raste emergjente mjekësore Kujdesi i dhëmbëve Njerëz të moshuar dhe njerëz me aftësi të kufizuara
		<b>28</b>
		<b>Martesa dhe familja .....</b>
		Martesa dhe bashkimi familjar Partneriteti i regjistruar Martesa me detyrim Planifikimi familjar dhe informacioni seksual Shtatzënia dhe lindja

Pushimi dhe shpërblimi i barë-lindjes  
 Shtesat familjare  
 Të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve  
 Probleme çiftesh dhe familjare  
 Dhuna shtëpiake

**Edukimi/koha e detyrueshme e shkollës.....33**

Shkolla popullore  
 Broshura: "Mundësi arsimimi në kantonin Thurgau"  
 Përgjegjësia e prindërve  
 Përkujdesja plotësuese për familje dhe shkollë  
 e fëmijës  
 Fëmijë me prejardhje me gjuhë të huaj  
 Kopshti i fëmijëve (që nga mbushja e moshës 4 vjeç)  
 Shkolla primare (që nga moshja 6 vjeç)  
 Shkolla sekondare I (që nga moshja 12 vjeç)

**Zgjedhja e profesionit/oferta ura .....36**

Këshillimi për profesionin dhe studimin  
 BIZplus Mbështetja për aplikimin  
 Oferta ura  
 Kurset e integritimit  
 Oferta kualifikimi me pengesa të ulëta

**Formimi profesional/shkolla të mëtejshme ..38**

Formimi profesional bazë (që nga moshja 15 vjeç)  
 Maturë profesionale  
 Shkollat e mesme (që nga moshja 15 vjeç)  
 Shkolla e Maturës Thurgauiane-Schaffhausiane  
 për të rritur

**Formimi i lartë profesional/shkollat e larta/  
 formimi i mëtejshëm .....40**

Formim i lartë profesional  
 Shkollat e larta  
 Kontributet për studimin dhe kualifikimin  
 Njohja e diplomave të huaja dhe e arritjeve të studimit  
 Formimi i mëtejshëm për të rritur

**Mbrojtja e mjedisit.....42**

Përkujdesja për mjedisin  
 Kujdesi ndaj hapësirës publike  
 Grumbullimi i mbeturinave  
 Riciklimi i mbeturinave  
 Mbeturina jo të riciklueshme

**Jeta sociale dhe shoqatat.....44**

Kultura  
 Sporti  
 Shëtitja, udhëtimi me biçikletë, patinazhi me rrota  
 Shoqatat  
 Angazhim me dobi publike  
 Feja

**Pjesëmarrja në jetën politike.....48**

Demokracia direkte  
 Organet politike  
 Tre nivelet politike  
 Të drejtat politike të personave të huaj  
 Forma të tjera të pjesëmarrjes politike  
 Marrja e shtetësisë

**Adresa të dobishme .....51**

## Kantoni, qarqet, komunat

Thurgau është një nga 26 kantonet e Konfederatës Zvicerane. Ai ka rreth 282'000 banorë dhe banorë (gjendja në vitin 2020), të cilët shpërndahen në pesë qarqe dhe 80 komuna. Kryeqyteti i tij është Frauenfeld me 25'800 banorë dhe banorë (gjendja në vitin 2020).

## Gjuha

Në Zvicër ka katër gjuhë zyrtare të vendit: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht. Kantoni Thurgau i përket Zvicrës gjermanofolëse. Si gjuhë zyrtare dhe e shkrimit në Zvicrën gjermane përdoret gjermanishtja letrare. Në jetën e përditshme flitet gjermanishtja zvicerane. Në Zvicrën gjermane ka shumë dialekte të ndryshme zvicerë-gjermane.

## Integrimi

Integrimi është një proces i përbashkët, i cili mbështetet mbi të drejtat dhe detyrimet e kushtetutës federale. Qëllimi është pjesëmarrja në jetën ekonomike dhe shoqërore e të gjitha grupeve të popullsisë. Nxitja e integrimit i përmbahet principit «nxit dhe kërkohet» dhe mbështet në veçanti mësimin e gjuhës, përparimin profesional dhe pjesëmarrjen sociale.

- 
- ▶ [www.tg.ch](http://www.tg.ch)
  - ▶ [www.thurgau-bodensee.ch](http://www.thurgau-bodensee.ch)



## Popullsia e huaj

Pjesa e personave me kombësi të huaj në kantonin Thurgau është tek 25.2 %. Popullsia e huaj vjen nga 140 vende të prejardhjes, shumica nga këto nga Evropa (94 %), 72 % nga BE-ja (gjendja në fund të vitit 2020).

## Politika e integritimit

Për nxitjen e bashkëjetesës autoritetet Thurgauiane ndjekin një politikë aktive të integritimit. Një numër i madh i komunave Thurgauiane është i lidhur me qendrat rajonale të kompetencave për integrimin. Këto qendra të kompetencave këshillojnë migrantet dhe migrantët lidhur me mësimin e gjuhës dhe integrimin profesional dhe social. Ato ofrojnë edhe një këshillim diskriminimi.


## Informacione në vend

- ▶ [3] Qendra e kompetencës për integrimin Qarku Frauenfeld
- ▶ [4] Qendra e kompetencës për integrimin Qarku Kreuzlingen
- ▶ [5] Qendra e kompetencës për integrimin Qarku Weinfelden
- ▶ [6] Qendra e kompetencës për integrimin Oberthurgau
- ▶ [7] Vendi i specializuar për integrimin Romanshorn
- ▶ [8] Vendi i specializuar për integrimin Amriswil
- ▶ [9] Vendi i specializuar për integrimin Arbon

- 
- ▶ [www.migraweb.ch](http://www.migraweb.ch)
  - ▶ [www.ch.ch](http://www.ch.ch)



**Nëse ju gjatë qëndrimit tuaj në Zvicër punoni ose qëndroni në Zvicër më tepër se tre muaj, ju keni nevojë për një leje qëndrimi. Kërkesën ju e paraqisni tek shërbimet për qytetarët të vendbanimit tuaj.**





## Lista kontrolli pas hyrjes

### Menjëherë pas hyrjes

- ❑ Regjistrohuni tek Zyra e regjistrimit të banorëve të vendbanimit (brenda 14 ditësh)
- ❑ Zhdoganoni mallrat e shpërnguljes
- ❑ Regjistroni fëmijët në shkollën popullore
- ❑ Lidhni një kontratë sigurimi shëndetësor dhe ndaj aksidenteve
- ❑ Hapni një llogari bankare ose postare
- ❑ Regjistrohuni në kursin e gjermanishtes

### Brenda muajve të parë

- ❑ Dorëzoni dëshminë e sigurimit shëndetësor në Zyrën e regjistrimit të banorëve
- ❑ Sqaroni të drejtën e shtesave për fëmijët që jetojnë jashtë vendit
- ❑ Regjistroni telefonin, televizorin, internetin, telefonin mobil

### Brenda një viti

- ❑ Shkëmbeni patentën
- ❑ Lidhni një kontratë sigurimi për automjetin
- ❑ Lini të provohet automjeti
- ❑ Ndërroni targën e makinës

### E rekomandueshme

- ❑ Lidhni një kontratë sigurimi për sendet shtëpiake
- ❑ Lidhni një kontratë sigurimi privat për përgjegjësinë ligjore
- ❑ Lidhni një kontratë sigurimi për mbrojtjen juridike
- ❑ Sqaroni të drejtën për reduktimin e primeve
- ❑ Merrni informacione në komunën tuaj mbi aktivitete të organizatave, sportive dhe kulturës

## Vlerat themelore

Një nga objektivat kryesore të kantonit është nxitja e mirëqenies së përgjithshme dhe e zhvillimit individual. Ai siguron veçanërisht që të respektohen ligji në fuqi, vlerat bazë të kushtetutës federale dhe siguria e rendi publik. Kantoni mund të ndërhyjë vetëm nëse ai për këtë është i autorizuar nga kushtetuta apo ligji. Ai është i organizuar sipas parimit të ndarjes së pushtetit.

## Sovran

Populli është sovran. Ai ushtron fuqinë e tij si në mënyrë direkte, duke votuar mbi kushtetutën dhe ligjet, ashtu edhe në mënyrë indirekte nëpërmjet autoriteteve të zgjedhura nga ai. Populli votues zgjedh autoritetet e komunës, qeverinë kantonale (Këshilli i qeverisë), parlamentin kantonial (Këshilli i madh) dhe ai zgjedh përfaqësuesit/përfaqësueset Thurgauiane për në këshillat e konfederatës.

## Të drejtat dhe detyrimet

Çdo person që jeton në kanton duhet t'i përmbushë detyrimet kushtetuese dhe ligjore: të paguajë tatimet e tij, të fusë fëmijët e tij në shkollë etj. Njëkohësisht vlejnë për të gjithë banoret dhe banorët të drejtat demokratike themelore, si e drejta e paprekshmërisë fizike, e barazisë së gruas dhe burrit, e mosdiskriminimit, e martesës si dhe e lirisë së fjalës dhe besimit.

---

### **Kushtetuta e kantonit Thurgau dhe ligje të tjera kantonale:**

▶ [www.rechtsbuch.tg.ch](http://www.rechtsbuch.tg.ch)

### **Ligje federale:**

▶ [www.fedlex.admin.ch](http://www.fedlex.admin.ch)




## Kufizimi i të drejtave

Të drejtat themelore nuk janë absolute. Kantoni mund t'i kufizojë ato, në mënyrë që të garantojë sigurinë, rendin dhe mirëqenien e përgjithshme. Liritë e individëve të veçantë përfundojnë aty ku fillojnë të drejtat e lirisë së bashkëqytetarëve. Kështu për shembull askush nuk mund t'i referohet lirisë së besimit, në mënyrë që të mos i respektojë ligjet e shkollës. Liria e fjalës nuk lejon p.sh. që të fyhet një person apo një grup personash.

## Kërkesa gjuhësore

► [1]

Ligji për të huaj dhe integrim (AIG) përcakton kërkesat e kushtëzuara gjuhësore për miratimin e lejes së qëndrimit. Zyra e migracionit provon gjendjen e integritit të shtetasve anëtarë të shteteve të treta në rast të një zgjatjeje të lejes së qëndrimit (B). Në rast të deficiteve të integritit "AIG" lejon gjithashtu prapësimin e miratimit të lejes së qëndrimit të përhershëm (C).



**Një përmbledhje për ofertat e ndryshme të kurseve të gjermanishtes dhe të qendrave të provimit për gjermanishten në kantonin Thurgau dhe rrethinat e afërta ju gjeni nën: ► [www.migrationsamt.tg.ch/integration](http://www.migrationsamt.tg.ch/integration)**

### **Të mësuarit e gjermanishtes**

Për të lëvizur lirshëm dhe i pavarur në Thurgau është e domosdoshme të mësohet gjermanishtja. Gjuha gjermane ju lehtëson juve që të kuptoheni me fqinjët dhe fqinjët, me mësuesit e fëmijëve tuaj, me autoritetet dhe persona të tjerë.

Në kantonin Thurgau organizata të ndryshme bamirëse, shoqata dhe shkolla ofrojnë kurse të gjermanishtes për folësit e gjuhëve të huaja. Një pjesë e këtyre kurseve është subvencionuar nga shteti dhe ofrohet kështu për një çmim të reduktuar. Ka edhe kurse vetëm për gra (pjesërisht me strehë të integruar për fëmijë).

### **Të mësosh gjermanishten zvicerane**

► [3], [10]

Gjuhët e folura, si dialektet, mësohen para së gjithash në bisedë me personat e tjerë. Zotërimi i një dialekti mund të jetë shumë i dobishëm, para së gjithash në profesion. Ka edhe kurse të gjermanishtes zvicerane, për shembull tek qendra e kompetencës për integrim në Frauenfeld ose tek shkolla e klubit Migros.



## Përkthimi ndërkulturore

- ▶ [www.ar.ge.ch](http://www.ar.ge.ch)
- ▶ [11]

Në situata të caktuara është e arsyeshme, nëse migrante dhe migrantë pa njohuri të gjermanishtes mbështeten nga përkthyes ndërkulturore. Këta janë të kualifikuar, që të nxisin ndërkuptimin me njëri-tjetrin, të parandalojnë keqkuptime dhe të ndihmojnë migrantet dhe migrantët gjatë integritimit në ambientin e tyre të ri.

Shërbimi nacional i përkthimit telefonik 0842 442 442 është i arritshëm përgjatë 24 orësh dhe ndërmjetëson brenda pak minutash përkthyes profesionistë në më shumë se 50 gjuhë në telefon.

Këshillohet fuqimisht që të mos vihen fëmijët të shërbejnë për përkthim.

## Biblioteka ndërkulturore

- ▶ [12]

Shoqata Biblioteka e Kulturave (VBdK) jep një kontribut për integrimin, duke nxitur kompetencat e gjuhës dhe leximit të njerëzve, të cilët jetojnë me dy ose më shumë gjuhë. Përveç kësaj ajo ofron një vend takimi për njerëzit e të gjitha gjuhëve dhe kontribuon me aktivitete të shumëllojshme në shkëmbimin ndërkulturore. Fondi i Bibliotekës së Kulturave është i integruar në Bibliotekën e kantonit Thurgau.



## Të gjendet një banesë

Banesa me qira ju gjeni në reklamat në gazeta, në internet dhe nëpërmjet agjencive të pasurive të paluajtshme. Për të marrë një kontratë të qirasë ju duhet të plotësoni një formular regjistrimi dhe t'i paraqisni administratës së pasurive të paluajtshme dokumente të caktuara, p.sh. ekstraktin e regjistrimit të zbatimit të detyrueshëm (► [www.betreibungsamt.tg.ch](http://www.betreibungsamt.tg.ch)), vërtetimin e pagës ose kontratën e punës.

## Sigurim i sendeve shtëpiake dhe sigurim për përgjegjësi në ligjore

Sigurimi i sendeve shtëpiake mbron pronën tuaj private, në mënyrë të veçantë pajisjet e shtëpisë (mobilet, qilimat etj.), mallrat tuaja të përdorimit (enët, veshjet, televizorin, impiantin stereofonik etj.) dhe sendet tuaja me vlerë (stoli, të holla të gatshme etj.) nga zjarri, goditjet e rrufesë, vjedhjet, dëmet nga stuhia apo uji etj.

Sigurimi privat për përgjegjësinë ligjore është, krahas sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, sigurimi më i rëndësishëm. Në disa kontrata qiraje ai është i detyrueshëm. Nëse ju i shkaktoni gabimisht një personi tjetër një dëm, ju, sipas ligjit, mbani përgjegjësi me pasurinë tuaj private në lartësi të pakufizuar. Me një shumë të vogël ju mund t'ia kaloni siguruesit tuaj rrezikun e përgjegjësisë ligjore. Sigurimi për përgjegjësinë ligjore përfshin edhe dëme në sendet e qirasë ose përgjegjësi ligjore të ndërtesës.



## Taksa për radio dhe televizor

► [www.serafe.ch](http://www.serafe.ch)

## Jeta në një shtëpi me qira

► [13]

Çdo ekonomi shtëpiake duhet të paguajë taksat për marrjen për aparatet e radios dhe të televizorit. Vendi për marrjen e taksave për kapjen e radios dhe televizorit në Zvicër (Serafe) merr automatikisht adresën tuaj nga shërbimet për qytetarët të komunës suaj të vendbanimit.

Të gjithë banoret dhe banorët në një shtëpi me qira duhet të ndjekin rregullat e përgjithshme të bashkëjetesës. Kështu, për shembull, duhet mënjanuar zhurmë e tepruar gjatë natës si dhe në ditët e diela dhe ato të festave. Rregullat specifike për shfrytëzimin e hapësirave të përbashkëta, si kuzhina e larjes, mund të lexohen në rregulloren e shtëpisë, e cila i është bashkëngjitur kontratës së qirasë. Prezantohuni pas hyrjes suaj në banesën e re tek fqinjët dhe fqinjët. Kjo çmohet dhe ju hap shumë dyer.

Në rast të vështirësive me qiramarrëse dhe qiramarrës të tjerë, dialogu është zgjidhja më e mirë. Në rast emergjence ju mund të flisni edhe me mirëmbajtësin e shtëpisë ose me qiradhënësin. Në rast të grindjeve ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit ju mund t'i drejtoheni ►[13] Konsultores juridike të Shoqatës së qiramarreseve dhe qiramarrësve.



## Veturat

- ▶ [www.strassenverkehrsamt.tg.ch](http://www.strassenverkehrsamt.tg.ch)
- ▶ [14]

## Importimi i automjeteve private

## Shkëmbimi i patentës

Për shfrytëzimin e autostradave dhe rrugëve automobilistike në Zvicër duhet të blihet një vinjetë, të cilën duhet ta ngjiti brenda në xhamin e përparmë. Vinjetën ju mund ta blini në pika të ndryshme të shitjes (doganë, garazhe, pika karburanti, zyra të qarkullimit rrugor, zyra të postës) për 40 franga (çmimi në vitin 2020). Ka vetëm vinjeta vjetore (të vlefshme përkatësisht nga 1 dhjetori i vitit paraprak deri më 31 janar të vitit të ardhshëm). Në Zvicër vlejné kufizimet e mëposhtme të shpejtësisë: 50 km/h brenda vendbanimeve, 80 km/h jashtë vendbanimeve, 120 km/h në autostrada. Në vendbanime ka zona me shpejtësi 30 km/h ose 20 km/h. Vlera maksimale e lejueshme e alkoolit në gjak është 0.5 ‰.

Nëse ju më pak se gjashtë muaj më parë keni blerë një makinë jashtë vendit, atëherë ju duhet të paguani një taksë gjatë importimit të kësaj në Zvicër. Nëse blerja ishte më shumë se gjashtë muaj më parë, automjetet llogariten si mallra të shpërnguljes dhe janë të liruar nga taksat. Një makinë ose motor e/i regjistruar jashtë vendit mund të drejtohet lirshëm në Zvicër për maksimalisht dymbëdhjetë muaj, përderisa është lidhur një kontratë për sigurimin e dëmit.

Ju duhet që brenda dymbëdhjetë muajsh pas hyrjes suaj ta shkëmbeni patentën tuaj të huaj kundrejt një patente zvicerane. Kushtet janë të ndryshme sipas vendit të origjinës. Për udhëtime profesionale me qëllim transportimi të personave apo mallrave, patenta e huaj duhet të shkëmbehet para udhëtimit të parë.

Patenta, të cilat janë marrë më pak se një vit para hyrjes në Zvicër, i nënshtrohen një kohe prove prej gjithsej tre vjet. Brenda një viti pas hyrjes duhet të kryhet një kurs i formimit të mëtejshëm.



## Qarkullimi publik

► [www.sbb.ch](http://www.sbb.ch)

Zvicra posedon një rrjet të dendur dhe efikas të transportit publik. Biletat për tren, autobus dhe anije janë relativisht të shtrenjta. Hekurudha Federale e Zvicrës (SBB) ofron abonime të ndryshme, me të cilat ju mund të shfrytëzoni transportin publik me çmim më të arsyeshëm (për shembull GA (abonim i përgjithshëm), Halbtax [gjysmë taksa], abonimi mujor, seven25).

Fëmijët deri në moshën gjashtë vjeç bashkudhëtojnë falas. Fëmijët nga gjashtë deri në 16 vjeç udhëtojnë falas me Junior-Karte, kur shoqërohen nga një prind (30 franga për vit, çmimi në vitin 2020). Fëmijë nga gjashtë deri 16 vjeç, të cilët udhëtojnë vetë, paguajnë gjysmën e çmimit për biletë. Nëse dëshironi të shfrytëzoni mjetet e transportit publik para së gjithash në Zvicrën e lindjes, ju mund të blini tek lidhja tarifore Ostwind një biletë ose një abonim, i cili është i vlefshëm brenda zonave të caktuara ose në të gjithë Zvicrën e lindjes.

► [www.ostwind.ch](http://www.ostwind.ch)

## Biçikleta si dhe këmbësore e këmbësorë

- [www.thurgau-bodensee.ch](http://www.thurgau-bodensee.ch)
- [www.provelothurgau.ch](http://www.provelothurgau.ch)
- [www.ch.ch/de/velofahren-der-schweiz/](http://www.ch.ch/de/velofahren-der-schweiz/)

Udhëtimi me biçikletë është ruajtës i ambientit, i leverdishëm dhe i shëndets-hëm. Autoritetet nxisin qarkullimin e biçikletave dhe të këmbësorëve. Dëme eventuale, të cilat ju i shkaktoni me biçikletën, janë të mbuluara nga sigurimi juaj privat për përgjegjësinë ligjore.



## Të gjendet një vend pune

- ▶ [www.rav.tg.ch](http://www.rav.tg.ch)
- ▶ [www.bizplus.tg.ch](http://www.bizplus.tg.ch)
- ▶ [www.ostjob.ch](http://www.ostjob.ch)
- ▶ [www.arbeit.swiss](http://www.arbeit.swiss)

## Rroga

## Mbrojtja nga prishja e kontratës së punës

Për të gjetur një punë, është i këshillueshëm një kombinim i metodave të ndryshme të kërkimit. Ju mund të bëni një kërkesë në ofertat për vende pune në gazetë dhe në internet, të dërgoni kërkesa spontane në ndërmarrje, të lidhni kontakt me zyrat për ndërmjetësimin e vendeve të punës dhe të regjistroni tek qendra rajonale për ndërmjetësim pune (RAV).

Në Zvicër janë rrogat bruto relativisht të larta; e njëjta vlen megjithatë edhe për kostot e jetesës. Nuk ka një rrogë minimale të vlefshme për të gjitha degët. Shumë degë njohin megjithatë rroga minimale sipas kontratave kolektive të punësimin.

Ligji mbron të punësuarit në rast sëmundjeje, aksidenti, shtatzënie dhe barrë-lindjeje nga prishja e kontratës. Një prishje kontrate gjatë kësaj hapësire kohore është si rregull e pavlefshme. Një prishje kontrate është keqpërdoruese, nëse ajo bëhet, për shembull, sepse dikush kërkon të drejta nga marrëdhënia e punës. Në rast të një prishje keqpërdoruese kontrate, personi i punësuar nga ana tjetër nuk mund të integrohet përsëri në ndërmarrje; mund të bëhet i vlefshëm vetëm një zhdëmtim para gjyqit.



## Tatimet

- ▶ [20]
- ▶ [www.steuerverwaltung.tg.ch](http://www.steuerverwaltung.tg.ch) > Download eFisc

Në Zvicër persona privatë paguajnë taksë mbi të ardhurat dhe pasurinë. Me këto taksa financohen detyrat publike, të cilat i përmbushin federata, kantonet dhe komunat. Pak kohë pas ardhjes suaj në kanton, ju merrni nga zyra komunale e taksave një pyetësor, në mënyrë që të mund të caktohet shuma e përkohshme e taksave tuaja.

Nëse ju keni një kombësi të huaj dhe nuk posedoni një leje të përhershme qëndrimi (C), atëherë tatimi mbi pagën do të hiqet direkt nga rroga juaj (tatimi në burim). Nëse ju posedoni një leje të përhershme qëndrimi, atëherë ju i merrni në janar formularët për deklaratën tatimore. Ju mund t'i plotësoni këto online. Në rast të vështirësive ju mund të drejtoheni në administratën kantonale të financës ose në një këshilltarë tatimore apo një këshilltar tatimor.

## Tensione në vendin e punës

- ▶ [21], [22]
- ▶ [www.sexuelle.belaestigung.ch](http://www.sexuelle.belaestigung.ch)

Në rast të konflikteve me punëdhënësin tuaj ose me bashkëpunëtorë, Lidhja e sindikatave të Thurgau-it mund t'ju këshillojë. Disa mënyra të sjelljes janë për arsye të ligjit, veçanërisht në vendin e punës, të ndaluara. Këto janë në mënyrë të veçantë mobingu dhe ngacmimi seksual si dhe fjalë, gjeste dhe veprime, të cilat poshtërojnë persona të tjerë



## Mosdiskriminimi

Në kushtetutën e Zvicrës shkruhet: «Askush nuk lejohet të diskriminohet, në mënyrë të veçantë jo për shkak të prejardhjes, të racës, të gjinisë, të moshës, të gjuhës, të bindjes fetare, botëkuptimore apo politike». Nëse ju për njëri nga këto arsye do të ndiheni të shpërfillur, ne ju këshillojmë që të kontaktoni njëri nga organizatat konfederative që vijojnë:

- ▶ [22] Zyra konfederative për barazinë e gruas dhe burrit (EBG)
- ▶ [23] Komisioni konfederativ kundër racizmit (EKR)

Në rast të diskriminimit racist ju mund të lini të këshilloheni në ▶[3–9] Qendrat e kompetencave dhe Vendet e specializuara për integrimin.

## Puna në të zezë

- ▶ [www.seco.admin.ch](http://www.seco.admin.ch)
- ▶ [24]

Edhe dikush, i cili në mënyrë të herëpashershme paguhet për punë të pastriimit, të shtëpisë dhe të kopshtit ose përkujdesjes së fëmijëve, vlen si i punësuar. Sipas kësaj, ai ose ajo duhet të regjistrohet nga punëdhënësi tek sigurimet sociale dhe punëdhënësi duhet ta llogarisë tatimin në burim, ndryshe bëhet fjalë për punë ilegale, të ashtuquajtur punë në të zezë.

Një person, i cili punësohet në të zezë, në rast të një invaliditeti apo një papunësie nuk ka asnjë të drejtë për pension invalidi ose për kompensim nga sigurimi i të papunëve dhe gjithashtu nuk do të marrë asnjë pension pleqërie. Pasojat për këtë arsye mund të jenë dramatike, para së gjithash në rast të një aksidenti në vendin e punës.

Për fat të keq ndodh që punëdhënës me dashje nuk dorëzojnë asnjë llogari të pagës, në mënyrë që në rast mosmarrëveshjeje të mohojnë një punësim. Në këtë rast për personin punëmarrës është pothuajse e pamundur të vërtetojë marrëdhënien e punës, por gjë që është e domosdoshme, në mënyrë që të marrë, për shembull, të holla për papunësinë.

## Sigurimi për papunësinë

- ▶ [16]
- ▶ [www.awa.tg.ch](http://www.awa.tg.ch)
- ▶ [www.arbeit.swiss](http://www.arbeit.swiss)

Nëse një person në Zvicër humb vendin e tij të punës, atëherë ai si rregull merr gjatë një hapësire të caktuar kohore një kompensim nga sigurimi i të papunëve. Parimisht, një person i huaj, i cili vjen për herë të parë në Zvicër, nuk ka asnjë të drejtë për kompensim nga sigurimi i të papunëve. Për këtë ai duhet të posedojë një leje të vlefshme qëndrimi dhe në dy vitet para regjistrimit të papunësisë të ketë ushtruar të paktën 12 muaj një veprimtari pune. Çdo person, i cili humb vendin e tij të punës, duhet sa më shpejt që të jetë e mundur, të regjistrohet tek qendra rajonale për ndërmjetësim pune (RAV), për të marrë kompensim nga sigurimi i të papunëve. Atje ai merr informacion mbi hapat që duhet të merren.

## Ndihma sociale

- ▶ [17–19]

Ndihma sociale duhet të sigurojë ekzistencën dhe të nxitë pavarësinë ekonomike dhe personale të personave në nevojë. Ajo jepet atëherë, nëse personi nuk mbahet nga familja e tij ose nuk mund të kërkojë shërbime të tjera ligjore. Për të kërkuar ndihmë sociale, duhet të kontaktohen Shërbimet sociale të bashkisë së banimit. ▶ [17] Zyra sociale e kontonit Thurgau ka një vend koordinimi. Këshillimi social dhe shkollor i ▶ [18] Karitasit Thurgau këshillon falas të gjithë kërkuarit e ndihmës, ofron ndihmë emergjente dhe asistencë kalimtare dhe ndërmjetëson institucione dhe vende të tjera këshillimi. ▶ [19] Fondacioni Benefo kryen këshillime buxheti me kosto të leverdishme.

## Kontribute të detyruara

- ▶ [15]

Sigurimet sociale mbrojnë banoret dhe banorët e Zvicrës nga rreziqet dhe sigurojnë ekzistencën e tyre ekonomike. Ato janë të detyrueshme dhe hiqen (me përjashtim të sigurimit shëndetësor ▶ kapitulli shëndeti) drejtpërdrejt nga paga. Kontributet e detyrueshme përbëjnë gjithsej rreth 20% të të ardhurave.

## **Përkujdesja: shtylla e 1-rë**


Në shtyllën e 1-rë dhe atëherë në përgjegjësinë e shtetit bëjnë pjesë sigurimi i pleqërisë dhe për të pasjetuarit (AHV), sigurimi i invaliditetit (IV) si dhe rregullorja e shpërbimit pas humbjes së të ardhurave (EO). Parimisht të gjithë personat banues në Zvicër i nënshtrohen „AHV“-ut, pavarësisht nga nacionaliteti dhe veprimtaria e punës. Moshë e pensionit është për burra 65 vjet dhe për gra 64 vjet (gjendja në vitin 2021). Është e mundur të dilet para kohe në pension. Në këtë rast pensioni do të shkurtohet përkatësisht.

## **Përkujdesja: shtylla e 2-të**

Në shtyllën e 2-të dhe atëherë në përgjegjësinë e punëdhënësit bën pjesë përkujdesja profesionale (BVG), në gjuhën e përditshme e quajtur edhe «arka e pensionit». Nga të ardhura vjetore prej 21'510 franga (gjendja në vitin 2021) hiqen kontributet prej pagës. Në shtyllën e 2-të bëjnë pjesë gjithashtu sigurimi shëndetësor për dieta [paga] ditore dhe sigurimi kundër aksidenteve në punë. Çdo person punëmarrës duhet të regjistrohet nga punëdhënësi apo punëdhënësjë tek një sigurim ndaj aksidenteve. Në rast të një zënie me punë prej tetë orësh në javë e më shumë janë të siguruara edhe aksidentet jashtë punës. Përndryshe është i nevojshëm një sigurim privat ndaj aksidenteve (► kapitulli shëndeti).

## **Përkujdesja: shtylla e 3-të**

Krahas shtyllës së 1-rë dhe shtyllës së 2-të, shtylla e 3-të është vullnetare dhe ndërtohet nga kursimet private. Përkujdesja 3a është një përkujdesje afatgjatë, tek e cila kapitali mbetet i lidhur për pensionin privat të pleqërisë. Kontribute të parakohshme janë të mundshme vetëm nën kushte të caktuara, për këtë mund të kursehen taksa me depozitim deri në një shumë të caktuar. Përkujdesja 3b është e lirë nga detyrimet shtetërore lidhur me depozitime, disponueshmërinë dhe momentin e pagesës.



## Sigurimi shëndetësor dhe ndaj aksidenteve

- ▶ [www.bag.admin.ch](http://www.bag.admin.ch)
- ▶ [www.gesundheit.tg.ch](http://www.gesundheit.tg.ch)

## Mjeket dhe mjekët

- ▶ [www.aerzte-tg.ch](http://www.aerzte-tg.ch)

Në rast ardhjeje nga jashtë shtetit ju duhet të lidhni brenda tre muajsh këtë sigurim. Nëse keni ardhur nga një kanton tjetër, ju duhet t'i paraqitni komunës suaj të re të banimit brenda 30 ditësh një dëftesë sigurimi.

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor siguron shërbime në rast të sëmundjes, të barrë-lindjes dhe aksidentit. Nëse ju jeni i punësuar, atëherë ju si rregull jeni i siguruar ndaj aksidenteve nëpërmjet ndërmarrjes. Kujdesuni në këtë rast për këtë, që ju të mos jeni të siguruar dyfish ndaj aksidenteve.

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon trajtimet mjekësore, medikamente të caktuara dhe qëndrimin në stacionin e përgjithshëm në spitalet e kantonit të banimit. Çdo person mund të lidhë një sigurim të padetyrueshëm si shtesë tek ky sigurim i detyrueshëm, i cili mbulon kosto të tjera si për shembull qëndrimin në spital në repartet private.

Shteti iu siguron personave të siguruar, çifteve dhe familjeve në rrethana ekonomike modeste miratim të uljes së çmimit të primit.

Lini të këshilloheni para lidhjes së një sigurimi dhe krahasoni ofertat e më shumë sigurimeve.

Këshillohet me ngut të zgjidhet sa më shpejt që të jetë e mundur një mjek familjeje ose një mjek familjeje. Në rast nevojë ju mund të drejtoheni tek mjekja juaj e familjes ose mjeku juaj i familjes, në mënyrë që ju të këshilloheni, të trajtoheni nga ana mjekësore dhe, nëse nevojitet, të udhëzoheni tek një mjek specialiste apo mjek specialist.



## Përkrahja shëndetësore dhe parandalimi

- ▶ [25–27]
- ▶ [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)
- ▶ [www.sozialnetz.tg.ch](http://www.sozialnetz.tg.ch)
- ▶ [www.femmestische.ch](http://www.femmestische.ch)

▶[25] Perspektivë Thurgau punon në përkrahjen shëndetësore dhe parandalimin. Oferta e saj përfshin këshillime për nëna dhe baballarë, këshillime për çiftet, familje dhe të rinj si dhe këshillime për varësinë. Gjithashtu në rast të pyetjeve për shëndetin seksual dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme, veçanërisht HIV dhe Sida, ju mund të drejtoheni në “Perspektivën Thurgau”.

Perspektivë Thurgau koordinon «Tryeza-Femmes». Këto raunde bisedash bashkojnë kryesisht gra me histori imigracioni, të cilat në raunde diskutimi, në kornizën private apo institucionale, merren me pyetje lidhur me edukimin, jetën e përditshme dhe shëndetin. Pjesëmarrësit, përveç kësaj, marrin informacione mbi kulturën e këtushme, mbi kurse të gjuhës, kopshte ditore femi-jësh, sistemin shkollor zviceran dhe sistemin e sigurimeve si dhe mbi vende të ndryshme të këshillimit.

Nëse ju ngarkon juve një situatë e rëndë e jetës dhe dëshironi që të flisni për këtë me njerëz të tjerë, të cilët përjetojnë gjëra të ngjashme, atëherë ju mund t’i bashkoheni një grupi të ndihmës për vetveten. ▶[26] “Ndhimja për vetveten Thurgau” ju informon mbi grupe ekzistuese për ndihmë për vetveten.



## Raste emergjente mjekësore

- ▶ Të gjitha rajonet janë të arritshme edhe nën 144.
- ▶ [www.stgag.ch](http://www.stgag.ch)

Nëse ju, në rast emergjent nuk e arrini mjeken tuaj të shtëpisë ose mjekun tuaj të shtëpisë, ju mund të kontaktoni mjeken e shërbimit ose mjekun e shërbimit të rajonit tuaj ose të një prej spitaleve të kantonit.

Në raste kritike duhet të telefonohet numri 144.

Mjekë shërbimi	Numri i telefonit
Rajoni Thurgau perëndimor	052 723 77 77
Rajoni Thurtal-Untersee	144
Rajoni Kreuzlingen	0900 000 199
Rajoni Amriswil-Obersee	0900 000 327
Rajoni Arbon	0900 575 420
Rajoni Romanshorn	0900 575 460
Rajoni Bischofszell	0900 575 422
Rajoni Rickenbach/Wilen/Busswil/Wil SG/Schwarzenbach SG	0900 56 85 56

Thurgau ShA	Numri i telefonit
Spitali i kantonit Frauenfeld	052 723 77 77
Spitali i kantonit Münsterlingen	071 686 11 11
Klinika St. Katharinental	052 631 60 60
Shërbimet psikiatrike Thurgau	071 686 41 41
Qendra e sqarimeve dhe pranimeve - psikiatri	0848 41 41 41

## Kujdesi i dhëmbëve

- ▶ [www.zahnaerzte-thurgau.ch](http://www.zahnaerzte-thurgau.ch)

Trajtime të përgjithshme të dhëmbëve, si në rast të kariesit dhe paradentozës apo korrigjimet e pozicioneve të dhëmbëve (aparate për drejtimin e dhëmbëve) nuk merren përsipër nga sigurimi bazë shëndetësor. Ju mund të lidhni një sigurim për shërbimin e dhëmbëve, para se të paraqiten probleme të mundshme.


## Njerëz të moshuar dhe njerëz me aftësi të kufizuara

- ▶ [www.sozialnetz.tg.ch](http://www.sozialnetz.tg.ch)
- ▶ [15], [28–32]

Informacione mbi shërbimin dhe përkujdesjen e njerëzve të moshuar mund të merren tek organizatat në vijim:

- ▶ [28] Lidhja „Spitex” Thurgau
- ▶ [29] „Pro Senectute“ Thurgau
- ▶ [30] Kryqi i Kuq Zvicëran Thurgau

Persona me një pengesë fizike ose psikike si dhe personat e tyre të kontaktit marrin këshilla dhe mbështetje tek Zyra e sigurimit të invaliditetit të kantonit, tek ▶[31] „Pro Infirmis“ ose - nëse ka të bëjë me fëmijë - tek ▶[32] Edukimi i hershëm pedagogjik terapeutik.



## Martesa dhe bashkimi familjar

► [33]

► [www.migrationsamt.tg.ch](http://www.migrationsamt.tg.ch)

## Partneriteti i të regjistruar

► [33], [34]

► [www.zivilstandsamt.tg.ch](http://www.zivilstandsamt.tg.ch)

► [www.binational.ch](http://www.binational.ch)

Kush dëshiron që të martohet në Zvicër, duhet të jetë të paktën 18 vjeç. Njihen vetëm martesat, të cilat janë lidhur në një zyrë të gjendjes civile. ► [33] Autoriteti për regjistrim tregtar dhe gjendjen civile ose Zyra e gjendjes civile e rrethit tuaj ju informon juve mbi kushtet paraprake që duhet të përmbushen dhe për dokumentet e nevojshme.

Nëse ju planifikoni hyrjen e bashkëshortes suaj të ardhshme respektivisht bashkëshortit tuaj të ardhshëm ose të një anëtari të familjes, duhet që paraprakisht të dorëzohet tek shërbimi i banorëve të komunës suaj të banimit një kërkesë për bashkim familjar. Për dhënien e lejes së qëndrimit është përgjegjëse ► [1] Zyra e migracionit. Në faqen e internetit të Zyrës së migracionit ju gjeni formularë të kërkesës dhe lista të dokumenteve që duhet të paraqiten.

Çifte me gjini të njëjtë kanë mundësinë, të lenë të njihet marrëdhënia e tyre, duke e regjistruar partneritetin e tyre. Zyra e gjendjes civile e rrethit, në të cilin jeton njëri nga dy partnerët respektivisht njëra nga dy partneret, informon mbi hapat që duhet të merren.



**Martesa me detyrim**

▶ [19], [35]

Askush nuk ka të drejtë që të detyrojë një grua apo një burrë, që të martohet kundër vullnetit të saj përkatësisht vullnetit të tij. Një martesë me detyrim është një vepër penale. Ajo është një ndërhyrje masive në lirinë personale. Ajo dëmton të drejtat themelore të njeriut, të cilat mbrohen nga kushtetuta federative dhe kushtetuta e kantonit Thurgau.

**Planifikimi familjar dhe informacioni seksual**

▶ [19], [25]

Në rast të pyetjeve për planifikimin e familjes, shtatzëninë (për shembull kontrolle para lindjes) ose për jetën seksuale, ju mund të drejtoheni tek ▶[19] Vendi i këshillimit për planifikimin e familjes, shtatzëninë dhe seksualitetin të fondacionit Benefo. Në rast të pyetjeve për shëndetin seksual ju qëndrojnë juve në dispozicion edhe mjekja e familjes ose mjeku i familjes si dhe ▶[25] Perspektive Thurgau.

Me vendet e përmendura ju mund të bisedoni mbi tema si parandalimi, seksualiteti, orientimi seksual, shtatzënia, ndërprerja e shtatzënisë, sëmundje seksualisht të transmetueshme, abuzimi seksual, ndjenjat dhe marrëdhëniet. Këto këshillime janë falas respektivisht të siguruar në sigurimin shëndetësor dhe janë me fshehtësi të madhe.

Vdekshmëria foshnjore në Zvicër është shumë e ulët. Kontrollat paraprake mjekësore falas nga java e 13-të e shtatzënisë dhe gjatë kohëzgjatjes së mbetur të shtatzënisë, kurset përgatitore të lindjes dhe këshillime për dhënie e gjirit kontribuojnë në këtë. Komplikime deri në fund të javës së 12-të të shtatzënisë llogariten si sëmundje dhe i nënshtrohen detyrimit të pjesëmarrjes në shpenzimet (kontributi vetjak dhe ekskluziviteti). Këshillimi për nëna dhe baballarë si dhe këshillimi për fëmijën e vogël, të cilat ofrohen nëpërmjet ▶[25] “Perspektivës” dhe “conex familia”, qëndrojnë në dispozicion si oferta të rëndësishme falas.

- 
- ▶ [www.sozialnetz.tg.ch](http://www.sozialnetz.tg.ch)
  - ▶ [www.conexfamilia.ch](http://www.conexfamilia.ch)
  - ▶ [www.guter-start-ins-kinderleben.tg.ch](http://www.guter-start-ins-kinderleben.tg.ch)

## Shtatzënia dhe lindja

- ▶ [19]
- ▶ [www.tageo.ch](http://www.tageo.ch)
- ▶ [www.femmetistische.ch](http://www.femmetistische.ch)
- ▶ [www.sozialnetz.tg.ch](http://www.sozialnetz.tg.ch)

## Pushimi dhe shpërblimi i barë-lindjes

- ▶ [www.bsv.admin.ch](http://www.bsv.admin.ch)
- ▶ [15]

- 
- ▶ [www.perspektive-tg.ch/muetter-und-vaeter-beratung](http://www.perspektive-tg.ch/muetter-und-vaeter-beratung)

Çdo lindje duhet t'i njoftohet zyrës së gjendjes civile të rrethit tuaj. Lindet fëmija në një spital, atëherë spitali ia njofton lindjen zyrës së gjendjes civile. Gjatë një lindjeje në shtëpi duhet të kujdesen prindërit për regjistrimin. Kërkesa për dhënien e një leje qëndrimi drejtuar Zyrës së migracionit do të paraqitet nëpërmjet shërbimeve të banorëve të komunës pa ndihmën tuaj.

I sapolinduri është i siguruar automatikisht në sigurimin shëndetësor për tre muaj që nga lindja. Që atëherë prindërit duhet të kenë lidhur një sigurim shëndetësor në emrin e fëmijës.

Pas lindjes gratë me veprimtari pune kanë pretendim për një pushim barë-lindjeje të paguar prej të paktën 14 javësh. Në këtë kohë ato marrin deri në 80 % të rrogës së tyre. Për këtë ato duhet të kenë paguar gjatë nëntë muajve para lindjes kontributet për sigurimet shoqërore dhe të kenë punuar të paktën gjatë pesë muajve. Kohët e sigurimit të realizuara në një shtet të BE-së ose EFTA-së do të merren gjithashtu parasysh. Duke filluar nga 1 janari 2021, baballarë me veprimtari pune kanë të drejtë për lejen e atësisë prej dy javësh.



► [15] Arka e kompensimeve të kantonit Thurgau ju jep juve për këtë informacione më të sakta.

## Shtesat familjare

► [15]

Nëse keni fëmijë të cilët jetojnë në kantonin Thurgau, ju keni të drejtë për një shtesë fëmijësh. Për fëmijë deri në përfundim të vitit të 16-të të jetës, kjo është 200 franga për muaj për fëmijë. Pas kësaj, në vend të shtesës për fëmijën ka një shtesë (më të lartë) për formim profesional për muaj dhe fëmijë deri në përfundimin e mësimit të profesionit të fëmijës suaj, më së gjati deri në vitin e 25-të të jetës së tij. Kjo e drejtë krijohet, në rrethana të caktuara, që nga përfundimi i vitit të 15-të të jetës. Shtesat familjare i transferon si rregull punëdhënësi me pagën. Prindër jo të zënë me punë mund të marrin, nën kushte të caktuara, shtesa fëmijësh apo shtesa për formim profesional.

► [15] Arka e kompensimeve e kantonit Thurgau ju jep juve informacion lidhur me këtë.

## Të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve

► [19], [35]

► [www.tschau.ch](http://www.tschau.ch)

Sikur të rriturit edhe fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta themelore. Ata kanë veçanërisht të drejtë për mbrojtje kundër keqtrajtimit, dhunës, abuzimit seksual dhe shfrytëzimit nëpërmjet punës si dhe të drejtë për edukim dhe një standard të përshtatshëm të jetesës (strehim, veshje, ushqim). Prindërit nuk kanë të drejtë t'i rrahin fëmijët dhe të rinjtë dhe ata gjithashtu nuk kanë të drejtë të rrahin askënd. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për paprekshmëri trupore dhe për mbrojtje kundër lëndimeve trupore.

Prerjet e gjenitaleve femërore janë të ndaluara dhe ndëshkohen juridikisht rëndë, edhe nëse ato kryhen në mjedisin familjar apo gjatë qëndrimeve jashtë vendit.

## Probleme çiftesh dhe familjare

- ▶ [www.paarberatungen-tg.ch](http://www.paarberatungen-tg.ch)

## Dhuna shtëpiake

- ▶ [19], [35–37]

Persona, të cilët kanë probleme me fëmijët e tyre ose brenda marrëdhënies së tyre si çift, gjejnë ndihmë tek vendet e këshillimit për çifte dhe familje. Në rast të një ndarjeje apo shkurorëzimi duhet ai prind, i cili nuk kujdeset për fëmijët, të paguajë kontribute mujore për mjetet e jetesës për fëmijët dhe ndoshta edhe për prindin tjetër. Informacione për ndihmën e pensionit ushqimor:

- ▶ [www.sozialamt.tg.ch](http://www.sozialamt.tg.ch) > Sozialhilfe > Alimentenhilfe

Kur persona brenda një lidhjeje martesore, partneriteti apo familjare ekzistuese ose që është në prishje e sipër ushtrojnë apo kërcënojnë dhunë fizike (goditje), psikike (kërcënime), seksuale (shtrëngim, përdhunim) ose ekonomike (mospagim i të hollave), atëherë flitet për dhunë shtëpiake. Kjo sjellje mund të ndëshkohet juridikisht, edhe nëse viktima nuk bënë kallëzim penal. Autorja apo autori i veprës duhet të llogarisë me dënime të rënda.

Sipas ligjit për mbrojtjen e viktimave mund të marrë çdo viktimë këshillim dhe ndihmë falas nga një zyrë e ndihmës së viktimave. Personeli i saj garanton fshehtësi të madhe.

- ▶ [19] Fondacioni Benefo, Vendi i specializuar i ndihmës për viktimat, Thurgau
- ▶ [35] Vende këshillimi për gra të prekura nga dhuna në Thurgau
- ▶ [36] Zyra e specializuar e dhunës shtëpiake, Policia e kantonit Thurgau
- ▶ Policia (telefon) për raste urgjente dhe ndihmë në vend: 117

Për persona që ushtrojnë dhunë ose kanë prirje për dhunë ka gjithashtu oferta këshillimi. Personeli garanton fshehtësi të madhe.

- ▶ [37] Konflikt.Gewalt – Këshillime për dhunën për burra, gra dhe të rinj
- ▶ Linja e drejtpërdrejtë (telefon) përgjatë 24 orësh për persona që ushtrojnë dhunë: 078 778 77 80



## Shkolla popullore

► [www.dek.tg.ch](http://www.dek.tg.ch)

Vijimi i shkollës popullore është i detyrueshëm për fëmijët, të cilët deri në fillimin e vitit shkollor në verë kanë mbushur katër vjet. Detyrimi për shkollë (përfshirë kopshtin e fëmijëve) zgjat njëmbëdhjetë vjet dhe vlen edhe për fëmijë dhe të rinj pa status të rregullt qëndrimi. Shkolla popullore është falas. Kompetent për sistemin e arsimit në kantonin Thurgau është Departamenti për Edukimin dhe Kulturën (DEK).

## Broshura: “Mundësi arsimimi në kantonin Thurgau”

► [www.dek.tg.ch](http://www.dek.tg.ch) > Publikationen und Downloads > Bildung

Broshura «Mundësi arsimimi në kantonin Thurgau» shpjegon sistemin e arsimit në kantonin Thurgau që nga fillimi i shkollës deri në shkollën terciare dhe është e disponueshme në gjuhë të ndryshme. Ajo përmban informacione të rëndësishme mbi shkollën popullore, sistemin e formimit profesional dhe shkollat e mëtejshme. Edhe adresa të pikave të këshillimit dhe kontaktit janë të përmbajtura aty.

## Përgjegjësia e prindërve

► [www.tageo.ch](http://www.tageo.ch)

Si prindër ju jeni përgjegjës për edukimin dhe formimin e plotë të fëmijëve tuaj. I ofroni fëmijës suaj që nga lindja një mjedis të sigurt dhe gjallërues! Lëvizje, kontakte sociale me fëmijë të së njëjtës moshë dhe me fëmijë, të cilët flasin gjuhën lokale, janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës suaj. Formimi i prindërve ju mbështet juve të përballoni detyrën me pretendime të edukimit. Edhe për një zhvillim të mirë shkollor të fëmijës suaj, ju si prindër mund të kontribuoni shumë: Përpiquni për një bashkëpunim të mirë me shkollën dhe kujdesuni për këtë, që fëmijët të paraqiten të çlodhur, të përkujdesur dhe në kohë në mësim. Nëse ju ftoheni nga shkolla në një bisedë ose në një mbrëmje të prindërve, ju jeni të detyruar që të merrni pjesë.

## **Përkujdesja plotë- suese për familje dhe shkollë e fëmijës**

► [www.sozialnetz.tg.ch](http://www.sozialnetz.tg.ch)

## **Fëmijë me prejardhje me gjuhë të huaj**

► [12], [40], [2-8]

---

## **Fol me mua dhe më dëgjo me vëmendje**

► Broshura në gjuhë të ndryshme në [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)

## **65 filma të shkurtër për të mësuarit në përditshmërinë e fëmijërisë së hershme:**

► [www.kinder-4.ch](http://www.kinder-4.ch)

## **Kurse në gjuhë dhe kulturën amtare:**

► [www.hsk-tg.ch](http://www.hsk-tg.ch)

Në kantonin Thurgau ka oferta të ndryshme përkujdesjesh për fëmijë, prindërit e të cilëve nuk mund të përkujdesen gjithmonë për ata, për shkak se ata janë, për shembull, me veprimtari pune. Varësisht nga mosha e fëmijëve dhe vëllimi i nevojshëm i përkujdesjes (në mëngjes, në mesditë, pas shkollës) ka oferta të ndryshme. Oferta të veçanta nxisin edhe kompetencat sociale, gjuhësore dhe motorike. Komuna juaj e banimit ju informon juve me kënaqësi mbi ofertat në rajonin tuaj.

Duke marrë parasysh vijimin e shkollës është e rëndësishme, që fëmija juaj të kuptojë gjuhën gjermane dhe të mund të komunikojë në gjermanisht. Njohuri të mira të gjermanishtes janë një parakusht bazë për vijimin e suksesshëm të shkollës. Një mundësi e mirë që tanimë para shkollës të mësohet gjermanishtja, ekziston në të shkuarit në një grup loje, kopsht ditor fëmijësh (KITA) ose familje ditore.

Edhe gjuha juaj amtare kontribuon për këtë, që fëmija juaj të mund të mësojë gjermanishten: I ofroni fëmijës suaj stimulime të shumëllojshme gjuhësore që nga lindja. Flisni me fëmijën tuaj dhe dëgjojeni atë, i tregoni atij tregime ose vjersha dhe këndonini me fëmijën tuaj këngë! Fëmija juaj mund të vijojë, përveç kësaj, kurse në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK), të cilat ofrohen nga konsullata e vendit tuaj ose nga anëtarë të bashkësisë suaj. Në këtë mësim fëmija juaj zgjeron kompetencën e tij gjuhësore në gjuhën amtare dhe përvetëson njohuri të kulturës së tij të origjinës. Në ►[12] Bibliotekën e kulturave mund të huazohen falas libra për fëmijë dhe të rinj në gjuhë të ndryshme.

Komunat e banimit apo ►[2-8] qendrat e kompetencave dhe vendet e specializuara për integrimin në rrethin tuaj ju ndihmojnë juve me kënaqësi gjatë kërkimit të një oferte të përshtatshme.

### **Kopshti i fëmijëve (që nga mbushja e moshës 4 vjeç)**

► [38]

### **Shkolla primare (që nga mosha 6 vjeç)**

► [38]

### **Shkolla sekondare I (që nga mosha 12 vjeç)**

► [38]

Kopshti i fëmijëve është shkalla e parë e arsimimit dhe zgjat 2 vjet. Në marrëdhënie loje fëmijët përvetësojnë parakushtet për vijimin e shkollës primare. Njëkohësisht nxiten kompetencat sociale. Fëmija juaj mëson në kopshtin e fëmijëve të lidhë kontakte dhe të shprehet në gjuhën lokale.

Shkolla primare zgjat gjashtë vjet. Ajo ndërmjetëson njohuri dhe aftësi bazë, nxit aftësitë individuale mendore, muzikale dhe fizike të fëmijëve dhe i edukon ata në veprim të pavarur dhe me plot përgjegjësi. Nxënëset dhe nxënësit zhvillojnë kompetenca, që të informohen dhe të mësojnë gjithnjë e më shumë të pavarur.

Shkolla sekondare zgjat tre vjet. Në këtë shkallë do të thellohen dhe zgjerohen përmbajtjet e arsimimit të shkollës primare. Të rinjtë ndërtojnë për veten një bazë solide për ecurinë e tyre profesionale dhe shkollore. Mësimi ofrohet në nivele të ndryshme të arritjeve.



## Këshillimi për profesionin dhe studimin

- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch)
- ▶ [39]

## BIZplus Mbështetja për aplikimin

- ▶ [www.bizplus.tg.ch](http://www.bizplus.tg.ch)

## Oferta ura

- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch)
  - > Brückenangebote
- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch) > BIZ

- 
- ▶ [www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch)
    - > Informationen in anderen Sprachen

Në shkollën sekondare I të rinjtë merren me synimet e tyre të formimit dhe profesionit si dhe me parakushtet dhe mundësitë e tyre përkatëse. Këshillimi për profesionin dhe studimin i mbështet ata në këtë proces. Në rast nevojë është e mundur si shtesë një mbështetje profesionale.

Qendra e informacionit për profesionin BIZplus ofron në Frauenfeld dhe Kreuzlingen një herë në javë këshillime falas për të gjithë personat banues në Thurgau. Ekspertet dhe ekspertët e specializuar të BIZplus ju ndihmojnë gjatë përgatitjes së dokumenteve të aplikimit dhe ju këshillojnë në rast të pyetjeve për kërkimin për vend pune, për formimin profesional dhe kualifikimin e mëtejshëm dhe mundësitë e karrierës.

Të rinjtë pa një zgjedhje vijuese pas shkollës sekondare I mund të marrin pjesë gjatë një viti në një ofertë urë kantonale. Gjatë kësaj ata mbështeten me pikësynim në procesin e zgjedhjes së profesionit. Ata mund t'i plotësojnë e thellojnë njohuritë e tyre bazë shkollore si dhe të mbledhin përvoja praktike në një ndërmarrje. Oferta kantonale dallon ndërmjet ofertave urë me fushë kryesore shkollore (tipi A) dhe ofertave urë me orientim praktik (tipi P).



## Kurset e integritimit

- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch)
  - > Integrationskurse
- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch) > BIZ

Në kurset kantonale të integritimit qëndron në qendër ndërmjetësimi i gjuhës gjermane dhe i formimit të përgjithshëm. Ato janë të hapura për të rinjtë dhe të rriturit ndërmjet moshës dymbëdhjetë dhe 34 vjeç. Ato krijojnë parakushtet për shkollën sekondare, një formim profesional bazë (EBA ose EFZ) ose një shkollë të mëtejshme. Ofrohen katër kurse të ndryshme të koordinuara ndërmjet njëra-tjetrës. Niveli i gjermanishtes vendos mbi zgjedhjen e kursit dhe kalimin për në kursin tjetër më të lartë të integritimit.

## Oferta kualifikimi me pengesa të ulëta

- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch)
  - > Niederschwelliges Ausbildungsangebot
- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch) > BIZ
- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch)
  - > Niederschwellige Integrationsausbildung

Të rinj të motivuar, të cilët nuk disponojnë parakushtet e nevojshme për një formim profesional bazë (EBA/EFZ), pas mbarimit të shkollës së detyrueshme mund të vijnë ofertën e kualifikimit me pengesa të ulëta. Kualifikimi zgjat dy vjet dhe përfshin, krahas praktikës në ndërmarrje, edhe mësim në një shkollë specifike profesionale. Ndërmjet të rinjve dhe ndërmarrjes kualifikuese lidhet një kontratë kualifikimi, e cila rregullon ndër të tjera shpërblimin e veprimtarisë praktike.

Për migrante dhe migrantë me gjuhë të huaj nga moshja 18 vjeç qëndron në dispozicion kualifikimi i integritimit me pengesa të ulëta.



**Në mbarim të kohës së detyrueshme të shkollës të rinjtë vendosin për një formim profesional bazë ose një shkollë të mëtejshme.**

### **Formimi profesional bazë (që nga mosha 15 vjeç)**

- ▶ [39]
- ▶ [www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch)  
> Lehrstellensuche

Rreth tre të katërtat e të rinjve mbarojnë një formim profesional bazë (mësim profesioni). Gjatë kësaj ata përvetësojnë në një ndërmarrje ku mësohet profesioni kompetencat e nevojshme për profesionin dhe vijnë një shkollë specifike profesionale në një deri dy ditë për javë. Të rinjtë marrin nga ndërmarrja e tyre ku mësohet profesioni një kontratë për mësim profesioni për kohëzgjatjen e kualifikimit dhe shpërblehen për punën e kryer. Formimi profesional bazë zgjat dy deri në katër vjet dhe përfundon me një certifikatë federale për profesionin (EBA) ose me një dëshmi konfederative aftësish (EFZ). Këto dëftesa janë të njohura në të gjithë Zvicrën.

### **Maturë profesionale**

- ▶ [39]

Matura profesionale (BM) plotëson formimin profesional bazë EFZ me një formim të përgjithshëm të zgjeruar. Ai mund të arrihet gjatë mësimin të profesionit (BM1) ose në vijim të një formimi profesional bazë EFZ (BM2). Matura profesionale mundëson hyrjen në një studim në një shkollë të lartë të specializuar dhe përgatit kështu për detyra me pretendime në ekonomi dhe shoqëri.

Me një provim të kryer shtesë, përveç kësaj, është i mundur një studim në një universitet apo në një shkollë të lartë konfederative teknike (ETH). Një kurs njëvjeçar “Passarellë” [kurs shtesë për hyrjen në universitet të personave me maturë profesionale] në shkollën e maturës Thurgauiane-Schaffhausiane për të rritur përgatit për këtë provim.

### **Shkollat e mesme (që nga mosha 15 vjeç)**

Pas kohës së detyrueshme të shkollës nxënëset dhe nxënësit mund të vijnë në një shkollë të mesme profesionale apo të informatikës ose një gjimnaz. Këto shkolla me kohë të plotë mundësojnë, sipas tipit të shkollës, një hyrje

- ▶ [41]
- ▶ [www.amh.tg.ch](http://www.amh.tg.ch)  
 > Mittelschulen

të drejtpërdrejtë në jetën profesionale ose një hyrje për në shkollat e larta të specializuara, në shkollat e larta universitare, në shkollat e lartë konfederative teknike (ETH) ose në shkollat e larta pedagogjike.

Tipi shkollor	Kohëzgjatja	Diploma
Shkolla e mesme profesionale	3 vjet	Librezë e shkollës së mesme profesionale
	4 vjet	Maturë e specializuar
Shkolla e mesme e informatikës	4 vjet	Informaticien/e EFZ me maturë profesionale
Gjimnazi	4 vjet	Dëftesë gjimnaziale e maturës

### Shkolla e Maturës Thurgauiane-Schaffhausiane për të rritur

- ▶ [43]

Të rritur të punësuar me parakushtet e nevojshme mund të kryejnë më vonë maturën në Shkollën e Maturës Thurgauiane-Schaffhausiane për të rritur (TSME) pa shkëputje nga puna. Për maturante dhe maturantë të kualifikuar mirë profesionalisht dhe të specializuar ekziston mundësia, të kryhet një kurs “Passarelle”. Kursi njëvjeçar “Passarelle” përgatit për provimin shtesë të njohur zviceran, i cili autorizon për hyrje në të gjitha shkollat e larta universitare zvicerane.



## Formimi i lartë profesional

- ▶ [www.sbf.admin.ch](http://www.sbf.admin.ch)
- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch)  
> Bildungszentren

## Shkollat e larta

- ▶ [41]
- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch) > Berufs- und Studienberatung

- ▶ [www.ecus-edu.ch](http://www.ecus-edu.ch)

Formimi i lartë profesional ndërmjetëson kualifikime, të cilat janë të nevojshme për kryerjen e një aktiviteti profesional me kërkesa të larta dhe me përgjegjësi. Ai, pas marrjes së një dëshmie konfederative aftësish (EFZ) apo një diplome të barasvlershme në shkallën sekondare II, mundëson një specializim dhe thellim të kompetencave profesionale dhe mund të ndërmjetësojë kualifikime në fushën e drejtimit të ndërmarrjes. Formimi i lartë profesional përfshin provimet konfederative (provimin profesional BP dhe provimin e lartë profesional HFP) dhe profilet arsimore në shkollat e larta profesionale (HF).

Zvicra ka lloje të ndryshme të shkollave të larta: shkollat e larta universitare, shkollat e larta të specializuara dhe shkollat e larta pedagogjike. Sistemi i arsimimit zviceran karakterizohet për përshkueshmëri të lartë: Kështu ka po ashtu rrugë të ndryshme për të filluar studimet në shkollën e lartë. Të rinj, të cilët kanë kryer një maturë profesionale apo një maturë të specializuar, mund të hyjnë në një shkollë të lartë të specializuar. Nëpërmjet një provimi “Passe-relle” personat me një maturë profesionale apo të specializuar përveç kësaj mund të fillojnë studimet në një universitet ose një shkollë të lartë konfederative teknike (ETH).

Të rinjtë, të cilët kanë përfunduar gjimnazin me një maturë të njohur zvicerane, mund të vijojnë universitetet, shkollat e larta konfederative teknike (ETH), shkollat e larta pedagogjike ose – pas një praktike njëvjeçare – shkollat e larta të specializuara.

Një person, i cili vjen nga jashtë shtetit, nuk pranohet automatikisht, edhe nëse ai në vendin e tij të origjinës ka hyrje në një shkollë të lartë. Në rast nevojë mund të kryhen provime shtesë për studimin në shkollën e lartë në Zvicër.



## Kontributet për studimin dhe kualifikimin

- ▶ [www.stipendien.tg.ch](http://www.stipendien.tg.ch)
- ▶ [42]

## Njohja e diplomave të huaja dhe e arritjeve të studimit

- ▶ [www.sbf.admin.ch](http://www.sbf.admin.ch)
- ▶ [44]
- ▶ [www.heks.ch/mosaik-ostschweiz](http://www.heks.ch/mosaik-ostschweiz)

## Formimi i mëtejshëm për të rritur

- ▶ [www.abb.tg.ch](http://www.abb.tg.ch)  
> Bildungszentren
- ▶ [www.weiterbildung.ch](http://www.weiterbildung.ch)
- ▶ [www.ausbildung-weiterbildung.ch](http://www.ausbildung-weiterbildung.ch)

Nën kushte paraprake të caktuara jepen bursa ose hua për mësimin e profesionit apo studimet. Informacione lidhur me këtë ju merrni tek ▶[42] Dega për kontributet e kualifikimit e seksionit për shkollat e mesme dhe të larta.

Përgjegjës për njohjen e diplomave, të cilat janë përfituar jashtë shtetit, në rast të kualifikimeve profesionale është Sekretariati i shtetit për arsim, kërkime shkencore dhe inovacion (SBFI). Për pranimin në një studim në një shkollë të lartë është përgjegjëse shkolla e lartë përkatëse.

Ndoshta ju posedoni përvojë profesionale prej më shumë se pesë vjet. Nën kushte paraprake të caktuara ju mund të lini të llogaritet përvoja juaj dhe të përfitoni një diplomë të një profesioni të njohur në Zvicër. ▶[44] Vendi i specializuar për përfundimin e profesionit për të rritur (BAE) ju jep juve me kënaqësi informacione lidhur me këtë.

Vendi i specializuar HEKS MosaiQ Ostschweiz [Zvicra e lindjes] ofron këshillim dhe përcjellje për migrante dhe migrantë të formuar mirë profesionalisht (për shembull në fushën e njohjes së diplomës, formimit të mëvonshëm).

Në Zvicër shumë të rritur ndjekin kurse të formimit të mëtejshëm, për të përmirësuar njohuritë e tyre të rëndësishme për profesionin ose për të përvetësuar njohuri të reja. Këto formime financohen pjesërisht nga punëdhënësi. Një person, i cili përgjatë gjithë karrierës së tij profesionale formohet mëtejshëm, ka perspektiva më të mira për të gjetur një vend pune të kënaqshëm për të dhe për të mundur të qëndrojë afatgjatë në jetën profesionale. Informohuni tek ndërmarrja juaj ose tek njëra prej qendrave të formimit në Thurgau.

## **Përkujdesja për mjedisin**

Thurgau, si një prodhues i rëndësishëm i produkteve ushqimore, kontribuon në mënyrë thelbësore në sigurimin e ushqimeve të Zvicrës. Bujqësia e tij me rreth 8'000 forcat e saj të punës formon një pjesë të rëndësishme përbërëse të ekonomisë popullore të Thurgau-t. Një mjedis i shumëllojshëm dhe ekologjikisht i vlefshëm duhet të nxitet dhe të mbrohet. Natyra jonë, malet dhe ujërat tona duhet të shfrytëzohen kujdesshëm dhe urdhëresa dhe ndalime duhet të respektohen. Për shembull është e ndaluar, që të ecet mbi ara, të dëmtohen pemët, të tremben kafshët ose të lihen mbeturinat mbrapa në natyrë.

## **Kujdesi ndaj hapësirës publike**

Çdo komunë posedon rregullore, të cilat informojnë mbi rregulla të sjelljes në hapësirën publike. Kështu në atë mund të lexohet, që mbeturinat duhet të hidhen në kazanët e mbeturinave, që është e ndaluar të bëhet pa nevojë zhurmë ose cilat masa duhet të merren, në mënyrë që kafshët shtëpiake të mos pengojnë. Tek shërbimet për qytetarët e komunës ju mund të kërkonti një kopje të rregullores.

## **Grumbullimi i mbeturinave**

Në Zvicër grumbullohet për qëllime të riciklimit, ndër të tjera, 95 % e qelqit (350'000 tonë për vit), 90 % e aluminit (13'000 tonë), 80 % e shisheve PET (40'000 tonë) dhe 80 % e letrës (1.2 Mio. tonë).

## **Riciklimi i mbeturinave**

Në ekonomitë shtëpiake mbeturinat ndahen me kujdes në plehra për djegien, në lëndë me vlerë për riciklimin dhe në mbeturina të veçanta (produkte helmuese). Të gjitha komunat kanë vendgrumbullime, si oborre të fabrikës, qendra rajonale të pranimit (RAZ) ose ndërmarrje private të shpërbërjes, ku dorëzohen mbeturinat që janë grumbulluar të ndara: qelqi, letra dhe kartoni, shisheet PET, plastika të përziëra, metale si kanoçe prej alumini dhe llamarine, pajisje elektrike, mbeturina të veçanta si bateritë, vajra dhe produkte helmue-

## Mbeturina jo të rriciklueshme

► [45]

se. Mbeturina të vetme si pajisje elektrike, bateri dhe PET mund të kthehen mbrapa edhe tek dyqanet e shitjes. Në këtë mënyrë ripërpunohen pothuajse gjysma e mbeturinave të grumbulluara.

Plehrat, pra mbeturina të cilat nuk mund të përpunohen, grumbullohen dhe digjen mundësisht në mënyrë ruajtëse për ambientin në një impiant të djegies së plehrave. Gjatë djegies së plehrave krijohen nxehtësia dhe rryma, të cilat shfrytëzohen. Ndalohet rreptësisht që ndonjë mbeturinë të lihet apo të depohet në hapësirën publike, të digjet jashtë apo në sobën vetjake. Gjithashtu është e ndaluar që mbeturina të lëngshme apo të forta të hidhen në tualet.

Kalendarët për shpërbërjen e mbeturinave në faqet e internetit të shoqatave KVA Thurgau dhe ZAB orientojnë mbi ditët e grumbullimit të plehrave në komunën përkatëse. Atje ju gjithashtu mësoni, ku mund të merrni thasët për mbeturina dhe kur mund t'i çoni ata në vendgrumbullimin për mbeturina. Plehrat duhet që të grumbullohen patjetër në qeset zyrtare, me detyrim pagese për plehra të KVA Thurgau dhe të ZAB, sepse hedhja e mbeturinave shtëpiake në kantonin Thurgau paguhet me këtë taksë. Për mbeturina kaba janë të disponueshme kuponë pagesash.

**Këshillim për mbeturina dhe kalendarë shumëgjuhësh mbeturinash, termine për grumbullime të veçanta**

- [www.kvatg.ch](http://www.kvatg.ch)
- [www.zab.ch](http://www.zab.ch)



## Kultura

- ▶ [46]
- ▶ [www.museen.tg.ch](http://www.museen.tg.ch)
- ▶ [www.thurgaukultur.ch](http://www.thurgaukultur.ch)

Kantoni Thurgau karakterizohet për peizazhin e tij të shumëllojshëm kulturor të decentralizuar. Të pasura janë gjurmët kulturore në kanton: një numër i madh kalash, kështjellash dhe rrënoja si dhe manastire, kisha dhe kapela, përveç kësaj, mallra artizanale dhe industriale. Në muzetë e Thurgau-t me koleksionet e tyre kulturore historike gjenden dëshmitarë kohe të të gjitha llojeve.

Në Thurgau lulëzon edhe arti bashkëkohor, për shembull në hapësirat dhe muzetë artistike në Kreuzlingen, Arbon, Frauenfeld ose në Kartause Ittingen.

Në Thurgau është e gjallë edhe skena muzikore. Qendra kulturore si “Dreispitz”, “Trösch” dhe arena e liqenit Bodensee në Kreuzlingen, panorama në Amriswil ose manastiri në Fischingen ofrojnë koncerte nga muzika klasike deri në muzikalet. Festivali ndërkombëtar i xhazit «Generations» në Frauenfeld tërheq adhuruesit e xhazit. Atje zhvillohet edhe “Openair Frauenfeld” - festivali më i madh i hip hopit në Evropë.

Kush e do teatrin shkon, për shembull, në ndërtesën e teatrit në Thurgau në Weinfelden, në teatrin “Theater an der Grenze” në Kreuzlingen, në teatrin



“Theaterwerkstatt Gleis 5” në Frauenfeld ose viziton një nga shumë teatrot në dritë të hapur.

## Sporti

- ▶ [47]
- ▶ [www.vtstg.ch](http://www.vtstg.ch)

## Shëtitja, udhëtimi me biçikletë, patinazhi me rrota

- ▶ [48]
- ▶ [www.thurgauer-wanderwege.ch](http://www.thurgauer-wanderwege.ch)
- ▶ [www.thurgau-bodensee.ch](http://www.thurgau-bodensee.ch)

Thurgau numëron rreth 860 shoqata të sportit. Qoftë për fëmijë, të rinj, të rritur apo njerëz të moshuar: ekziston një ofertë e gjerë e aktiviteteve sportive. Më shumë informacion ju merrni nga zyra e turizmit në rajonin tuaj, tek komuna juaj ose tek adresat e pranëvendusura.

Shëtitja është sporti më i pëlqyer në Zvicër. Nëpërmjet saj të rinj dhe të moshuar pushojnë dhe njihen me rajone të ndryshme të vendit. Në kantonin Thurgau ka 1'000 kilometra shtigje të shënuara shëtitjeje që janë të rezervuara ekskluzivisht për shëtitëse dhe shëtitës.

Përveç kësaj, Thurgau ju fton në udhë të shënuara biçikletash prej gjithsej 900 kilometrash të eksploronit me biçikletë në rrugë të sigurta zonat më të bukura, për shembull, në rrugën e biçikletave të liqenit Bodensee direkt përgjatë bregut të liqenit. Thurgau gjithashtu ofron kushtet më të mira paraprake për patinazh me rrota në një linjë. Informohuni në “Thurgau Tourismus” rreth mundësive të ndryshme.



## Shoqatat

- ▶ [www.thurgaukultur.ch](http://www.thurgaukultur.ch)
- ▶ [www.vtstg.ch](http://www.vtstg.ch)
- ▶ [www.tarjv.ch](http://www.tarjv.ch)

Tre të katërtat e popullsisë zvicerane mbi 15 vjeç janë anëtarë në një shoqatë ose një organizatë me dobi publike. Në shoqata janë aktivë njerëz, të cilët dëshirojnë të vepronë mbi bazë të përbashkët dhe vullnetare, në mënyrë që

- ▶ të ruajnë interesat e përbashkëta: sportin, kulturën, kohën e lirë etj.,
- ▶ të shprehin një dëshirë: prindër të nxënësve dhe nxënësve, migranteve dhe migrantëve, njerëzve të moshuar etj.,
- ▶ të angazhohen në fushën sociale dhe ekonomike: sindikatat, lidhjet profesionale, grupet e interesave etj.

Zvicra është një vend i lidhjeve dhe shoqatave. Në të gjithë vendin ka prej tyre dhjetëra mijëra, nga këto disa qindra në Thurgau. Shoqatat luajnë një rol qendror në jetën e përditshme të kantonit. Për shembull ka lidhje të sportit, shoqata kulturore si dhe bashkësi të migranteve dhe migrantëve, të cilat janë aktive në fusha të larmishme të veprimit.

Anëtarësimi në një shoqatë është shumë nxitës për integrimin në jetën lokale dhe lidhjen e kontaktit me qytetaret dhe qytetarët e Thurgau. Shoqatat iu qëndrojnë hapur të gjithë personave të interesuar. Këshillohuni në faqen e internetit të komunës suaj ose drejtohuni tek komuna juaj e banimit për informacione të mëtejshme mbi shoqata lokale.

## Angazhim me dobi publike

- ▶ [18], [30], [49–51]
- ▶ [www.benevol-jobs.ch](http://www.benevol-jobs.ch)
- ▶ [www.netzwerk-asyil-tg.ch](http://www.netzwerk-asyil-tg.ch)
- ▶ [www.migrationsamt.tg.ch/integration](http://www.migrationsamt.tg.ch/integration)

Nëpërmjet angazhimit me dobi publike ju mund të zgjeroni rrjetin tuaj social dhe të zhvilloni në mënyrë të drejtpërdrejtë rrethin tuaj. Ju mund të angazhoheni afatgjatë nëpërmjet organizatave ose për projekte të veçantë.

Aksione vullnetare në Thurgau koordinon ▶[49] Benevol. Informohuni edhe tek ▶[30] Kryqi i Kuq Zviceran, tek ▶[18] Karitasi ose tek ▶[50] HEKS. Nëse dëshironi të angazhoheni për refugjatë, drejtohuni tek rrethet e ndihmësve nga rrjeti “Azili Thurgau”.

Një përmbledhje e ofertave për integrim social në fushën e migracionit/azilit mund të gjendet në faqen e internetit të ►[2] vendit kantonal të specializuar për integrimin

## Feja

Kushtetuta e Zvicrës dhe Kushtetuta e kantonit Thurgau garantojnë lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes. Secili person mund të vendosë lirshëm, nëse ai dëshiron të jetë besimtar apo cilën fe dëshiron të praktikojë. Liria e fesë është me këtë një e drejtë individuale, të cilën secili person e ushtron lirshëm sipas bindjeve personale. Autoritetet njohin rolin e rëndësishëm të kishave dhe të bashkësive fetare në shoqëri. Krahas katolicizmit dhe protestantizmit, është islami bashkësia fetare e tretë më e madhe e kantonit. Krahas kësaj ekzistojnë grupime të tjera fetare. Të gjitha këto bashkësi ndajnë dëshirën e autoriteteve, që të përkujdesen për dialogun ndërmjet religjioneve dhe të ruajnë paqen fetare.

- Kisha katolike Thurgau: [www.kath-tg.ch](http://www.kath-tg.ch)
- Kisha evangjelike Thurgau: [www.evang-tg.ch](http://www.evang-tg.ch)
- Shoqata koordinuese e komuniteteve islame të Zvicrës së lindjes: [www.digo.ch](http://www.digo.ch)
- Federata komunale izraelite zvicerane: [www.swissjews.ch](http://www.swissjews.ch)



## Demokracia direkte

Pothuajse asnjë demokraci e botës nuk është kaq pjesëmarrëse sikur demokracia e Zvicrës. Të drejtat politike, të quajtura edhe të drejta të popullit, janë me ndikim të gjerë: e drejta e votës, e drejta e zgjedhjes, e drejta e iniciativës dhe e drejta e referendumit. Populli me të drejtë vote mund të propozojë kështu, të ndryshohet kushtetuta (e drejta e iniciativës) ose mund të kundërshtojë një ligj të hartuar nga parlamenti (e drejta e referendumit). Nëse në Zvicër bëhet fjalë për «sovrän», janë të kuptuara me këtë qytetarët dhe qytetarët zviceranë.

Të drejtat politike ushtrohen mbi tre nivelet e shtetit: Federata, kantonet, komunat. Popullit zviceran i kërkohet disa herë në vit që të votojë; kantonet dhe komunat zhvillojnë votimin e tyre si rregull në të njëjtën kohë me federatën. Këshilli federal, i cili formon qeverinë Zvicerane, zgjidhet nga parlamenti. Parlamenti zgjidhet nga populli dhe përbëhet nga dy këshille: këshillin nacional dhe nga përfaqësia e kantoneve.

## Organet politike

Organet e zgjedhura shpesh mbajnë emrin «këshill». Funkzioni i tyre qëndron në atë, që të mendojnë, të debatojnë dhe të parashtrajnë propozime, të cilat populli mund t'i pranojë apo t'i refuzojë.

## Tre nivelet politike

Popullit në Thurgau i kërkohet afërsisht katër herë në vit që të vendosë mbi çështje në të tre nivelet politike:

- ▶ Niveli komunal (për shembull, ndërtimi i një salle teatri)
- ▶ Niveli kantonal (për shembull, ndërtimi i një rruge kantoni)
- ▶ Niveli konfederativ (për shembull, ndërrimi i ligjit federal mbi sigurimin e invaliditetit)



Çdo katër vjet zgjidhen përfaqësueset dhe përfaqësuesit në parlament dhe qeveri në nivel komunal, kantonal dhe federal, si dhe gjykatëset dhe gjykatësit në gjykatat e rrethit.

Niveli politik	Niveli parlamentar	Niveli qeveritar
Komunat e Thuargau-it	Kuvendi komunal	Këshilli i komunës
Kantoni Thurgau	Këshilli i madh	Këshilltar qeveritar
Konfederata zvicerane	Këshilli nacional dhe përfaqësia e kantoneve	Këshilli federal

### Të drejtat politike të personave të huaj

► [33]

Nëse ju nuk jeni me kombësi zvicerane, nuk keni të drejtë votimi dhe vote në kantonin Thurgau dhe në komunat e Thurgau-t. Komuna të veçanta u mundësojnë të huajave dhe të huajve që të marrin pjesë me votë këshilluese në kuvendin komunal. Një përjashtim bëjnë kishat katolike, tek të cilat njerëzit me origjinë të huaj mund të aplikojnë për një të drejtë vote. Në komunitetin e shkollës ju mund të bëni kërkesë për një pjesëmarrje me votë këshilluese.



## Forma të tjera të pjesëmarrjes politike

► [51]

Krahas të drejtave politike, ka shumë mundësi të tjera për të marrë pjesë në jetën publike dhe për të krijuar së bashku të ardhmen e komunitetit. Një person, për shembull, mund të merret në çdo kohë me punë në një shoqatë të lagjes, në një bashkim lokal, në një organizatë profesionale, në një klub sportiv, në një komision këshillimi ose në një parti politike.

Një person i huaj i rritur apo i mitur zotëron të drejtën e peticionit si zviceranet dhe zviceranët. E drejta e peticionit i jep secilit mundësinë, të drejtojë pyetje, propozime, kritikë ose ankesë në autoritetet. Me këtë ka mundësi që të ndikohet mbi vendime të marra nga organet shtetërore.

## Marrja e shtetësisë

► [33]

Në kanton marrin çdo vit 800 deri në 1'000 persona shtetësinë dhe nëpërmjet kësaj mundësinë e plotë të pjesëmarrjes politike: të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur në nivel komunal, kantonal dhe federal. 12% e popullsisë zvicerane nga mosha 15 vjeç në kantonin Thurgau janë shtetase dhe shtetas të dyfishtë. Marrja e të drejtës së qytetarit zviceran është një vendim dhe shprehje vullneti personal. Kusht paraprak është një integrim i mirë në rrethanat vendore, kantonale dhe zvicerane. Për marrjen e shtetësisë në Thurgau është kusht paraprak minimal një nivel i certifikuar B2 me gojë dhe B1 me shkrim i gjermanishtes. Një listë e ofruesve të kurseve të gjermanishtes dhe certifikatave të njohura mund të gjeni në:

► [www.migrationsamt.tg.ch/integration](http://www.migrationsamt.tg.ch/integration)

Komuna juaj do t'ju informojë me kënaqësi për kushtet e marrjes së shtetësisë.

Institucionet e mëposhtme ju qëndrojnë në dispozicion për informacione më të hollësishme mbi temat, për të cilat ► numërimi përkatës është shënuar në kapituj.

- ▶ [1] **Migrationsamt des Kantons Thurgau [Zyra e migracionit e kantonit Thurgau]**  
Langfeldstrasse 53a  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 67 67  
migrationsamt@tg.ch  
www.migrationsamt.tg.ch
- ▶ [2] **Fachstelle Integration des Kantons Thurgau [Vendi i specializuar për integrim i kantonit Thurgau]**  
Bahnhofplatz 65  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 39 88  
integration.mia@tg.ch  
www.migrationsamt.tg.ch/integration
- ▶ [3] **Kompetenzzentrum Integration Bezirk Frauenfeld [Qendra e kompetencës për integrim Qarku Frauenfeld]**  
Kasernenplatz 4  
8500 Frauenfeld  
Tel. 052 724 56 60  
agi@stadtfrauenfeld.ch  
www.agi.frauenfeld.ch
- ▶ [4] **Kompetenzzentrum Integration Bezirk Kreuzlingen [Qendra e kompetencës për integrim Qarku Kreuzlingen]**  
Marktstrasse 4, 8280 Kreuzlingen  
Tel. 071 677 62 34  
zeljka.blank@kreuzlingen.ch  
www.kreuzlingen.ch
- ▶ [5] **Kompetenzzentrum Integration Bezirk Weinfelden [Qendra e kompetencës për integrim Qarku Weinfelden]**  
Pestalozzistrasse 14,  
8570 Weinfelden  
Tel. 071 622 04 06,  
andrea.keller@koibw.ch  
www.koibw.ch
- ▶ [6] **Kompetenzzentrum Integration Oberthurgau [Qendra e kompetencës për integrim Qarku Oberthurgau]**  
Hauptstrasse 12  
9320 Arbon  
Tel. 071 454 77 56  
franziska.schoeni@oberthurgau.ch  
www.oberthurgau.ch
- ▶ [7] **Fachstelle Integration Romanshorn [Vendi i specializuar për integrim Romanshorn]**  
Konsumhof 3, Postfach 36  
8590 Romanshorn  
Tel. 058 346 83 31  
marian.brenner@romanshorn.ch  
www.romanshorn.ch
- ▶ [8] **Fachstelle Integration Amriswil [Vendi i specializuar për integrim Amriswil]**  
Arbonerstrasse 2  
8580 Amriswil  
Tel. 071 414 12 34  
integrationsstelle@amriswil.ch  
www.amriswil.ch
- ▶ [9] **Fachstelle Integration Arbon [Vendi i specializuar për integrim Arbon]**  
Wallhallastrasse 2  
9320 Arbon  
Tel. 071 447 61 63  
lukas.feierabend@arbon.ch  
www.arbon.ch
- ▶ [10] **Klubschule Migros [Shkolla e klubit Migros]**  
Bahnhofplatz 70–72, Passage  
8500 Frauenfeld  
Tel. 058 712 44 50  
www.klubschule.ch
- ▶ [11] **ARGE Integration Ostschweiz [ARGE Integrimi Zvicra e lindjes]**  
Rorschacherstrasse 1, Postfach 61  
9004 St. Gallen  
Tel. 0848 28 33 90  
verdi@arge.ch  
www.arge.ch
- ▶ [12] **Bibliothek der Kulturen [Biblioteka e kulturave]**  
Promenadenstrasse 12  
8510 Frauenfeld  
info@bibliothekderkulturen.ch  
www.bibliothekderkulturen.ch

- ▶ [13] **Mieterinnen- und Mieterverband Ostschweiz**  
[*Shoqata e qiramarrëseve dhe qiramarrësve Zvicra e lindjes*]  
Webergasse 21  
9000 St. Gallen  
Tel. 071 222 50 29  
ostschweiz@mieterverband.ch  
www.mieterverband.ch/mv-os.html
- ▶ [14] **Strassenverkehrsamt des Kantons Thurgau**  
[*Seksioni i qarkullimit rrugor i kantonit Thurgau*]  
Moosweg 7a  
8500 Frauenfeld  
Tel. 058 345 36 36,  
www.stva.tg.ch
- ▶ [15] **Sozialversicherungszentrum Thurgau (SVZTG)**  
[*Qendra e sigurimit social Thurgau (SVZTG)*]  
St. Gallerstrasse 11  
8501 Frauenfeld  
Tel. 058 225 75 75  
info@svztg.ch  
www.svztg.ch
- ▶ [16] **Amt für Wirtschaft und Arbeit des Kantons Thurgau**  
[*Seksioni për ekonomi dhe punë i kantonit Thurgau*]  
Promenadenstrasse 8  
8510 Frauenfeld  
awa@tg.ch  
www.awa.tg.ch
- ▶ [17] **Sozialamt des Kantons Thurgau**  
[*Seksioni social i kantonit Thurgau*]  
Promenadenstrasse 16  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 68 20  
info.soa@tg.ch  
www.sozialamt.tg.ch
- ▶ [18] **Caritas Thurgau**  
[*Karitasi Thurgau*]  
Franziskusweg 3  
8570 Weinfelden  
Tel. 071 626 11 81  
thurgau@caritas.ch  
www.caritas-thurgau.ch
- ▶ [19] **Benefo-Stiftung**  
[*Fondacioni Benefo*]  
Zürcherstrasse 149  
8500 Frauenfeld  
Tel. 052 723 48 20  
benefo@benefo.ch  
www.benefo.ch
- ▶ [20] **Steuerverwaltung Thurgau**  
[*Administrata e financës Thurgau*]  
Schlossmühlestrasse 15  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 30 30  
info.sv@tg.ch  
www.steuerverwaltung.tg.ch
- ▶ [21] **Thurgauer Gewerkschaftsbund (TGGB) [Lidhja sindikale Thurgau (TGGB)]**  
Hohenzornstrasse 4  
8500 Frauenfeld  
Tel: 052 720 50 15  
info@tggb.ch, www.tggb.ch
- ▶ [22] **Eidgenössisches Büro für die Gleichstellung von Frau und Mann (EGB)**  
[*Zyra konfederative për barazinë e graas dhe burrit (EGB)*]  
Schwarztorstrasse 51  
3003 Bern  
Tel. 058 462 68 43  
ebg@ebg.admin.ch  
www.ebg.admin.ch
- ▶ [23] **Eidgenössische Kommission gegen Rassismus (EKR)**  
[*Komisioni konfederativ kundër racizmit (EKR)*]  
Inselgasse 1  
3003 Bern  
Tel. 058 464 12 93  
ekr-cfr@gs-edi.admin.ch  
www.ekr.admin.ch
- ▶ [24] **Arbeitsinspektorat des Kantons Thurgau**  
[*Inspektorati i punës i kantonit Thurgau*]  
Bahnhofplatz 65  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 56 30  
arbeitsinspektorat@tg.ch  
www.awa.tg.ch
- ▶ [25] **Perspektive Thurgau**  
[*Perspektiva Thurgau*]  
Schützenstrasse 15, Postfach 297  
8570 Weinfelden  
Tel. 071 626 02 02  
info@perspektive-tg.ch  
www.perspektive-tg.ch

- ▶ [26] **Selbsthilfe Thurgau**  
**[Vetëndihma Thurgau]**  
 Freiestrasse 10, Postfach 429  
 8570 Weinfelden  
 Tel. 071 620 10 00  
 info@selbsthilfe-tg.ch  
 www.selbsthilfe-tg.ch
- ▶ [27] **Amt für Gesundheit des Kantons Thurgau**  
**[Seksioni për shëndetësinë i kantonit Thurgau]**  
 Promenadenstrasse 16  
 8510 Frauenfeld  
 Tel. 058 345 68 40  
 gesundheit@tg.ch  
 www.gesundheit.tg.ch
- ▶ [28] **Spitex Verband Thurgau**  
**[Lidhja „Spitex“ Thurgau]**  
 Freiestrasse 6  
 8570 Weinfelden  
 Tel. 071 622 81 31  
 info@spitextg.ch  
 www.spitextg.ch
- ▶ [29] **Pro Senectute Thurgau**  
**[„Pro Senectute“ Thurgau]**  
 Rathausstrasse 17, Postfach 292  
 8570 Weinfelden  
 Tel. 071 626 10 80  
 info@tg.prosenectute.ch  
 www.tg.prosenectute.ch
- ▶ [30] **Schweizerisches Rotes Kreuz Kanton Thurgau**  
**[Kryqi i kuq zviceran Thurgau]**  
 Rainweg 3  
 8570 Weinfelden  
 Tel. 071 626 50 80  
 geschaeftsstelle@srk-thurgau.ch  
 www.srk-thurgau.ch
- ▶ [31] **Pro Infirmis Thurgau-Schaffhausen**  
**[„Pro Infirmis“ Thurgau-Schaffhausen]**  
 Marktstrasse 8  
 8501 Frauenfeld  
 Tel. 058 775 22 35  
 thurgau@proinfirmis.ch  
 www.proinfirmis.ch
- ▶ [32] **Heilpädagogische Früherziehung Thurgau**  
**[Edukim i hershëm pedagogjik terapeutik Thurgau]**  
 Thundorferstrasse 3  
 8500 Frauenfeld  
 Tel. 052 722 20 17  
 info@hfe-tg.ch  
 www.hfe-tg.ch
- ▶ [33] **Amt für Handelsregister und Zivilstandswesen des Kantons Thurgau**  
**[Seksioni për regjistrim tregtar dhe gjendjen civile i kantonit Thurgau]**  
 Bahnhofplatz 65  
 8510 Frauenfeld  
 Tel. 058 345 70 70  
 sekretariat.hz@tg.ch  
 www.hz.tg.ch
- ▶ [34] **HOT Homosexuelle Organisation Thurgau**  
**[HOT Organizata homoseksuale Thurgau]**  
 Wilerstrasse 3  
 9545 Wängi  
 info@hot-tg.ch  
 www.hot-tg.ch
- ▶ [35] **Beratungsstelle für gewaltbetroffene Frauen Thurgau**  
**[Vende këshillimi për gra të prekur nga dhuna në Thurgau]**  
 Oberstadtstrasse 7, Postfach 1002  
 8500 Frauenfeld  
 Tel. 052 720 39 90  
 kontakt@frauenberatung-tg.ch  
 www.frauenberatung-tg.ch
- ▶ [36] **Fachstelle Häusliche Gewalt**  
**[Zyra e specializuar “Dhuna shtëpiake”]**  
 Kantonspolizei Thurgau  
 Dunantstrasse 14  
 8570 Weinfelden  
 Tel. 052 728 24 50  
 fachstellehg@kapo.tg.ch  
 www.kapo.tg.ch
- ▶ [37] **Konflikt. Gewalt – Gewaltberatung für Männer, Frauen und Jugendliche**  
**[Konflikt.Gewalt – Këshillime për dhunën për burra, gra dhe të rinj]**  
 Gaswerkstrasse 15  
 8750 Weinfelden  
 Tel. 078 778 77 80  
 kontakt@konflikt-gewalt.ch  
 www.konflikt-gewalt.ch
- ▶ [38] **Amt für Volksschule des Kantons Thurgau**  
**[Seksioni për shkollën popullore i kantonit Thurgau]**  
 Spannerstrasse 31  
 8510 Frauenfeld  
 Tel. 058 345 57 70  
 info@av.tg.ch  
 www.av.tg.ch

- ▶ [39] **Amt für Berufsbildung und Berufsberatung des Kantons Thurgau** [*Seksioni për formim profesional dhe këshillim profesional i kantonit Thurgau*]  
Grabenstrasse 5, 8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 59 30  
abb@tg.ch, www.abb.tg.ch
- ▶ [40] **Kontaktstelle Heimatliche Sprache und Kultur (HSK) des Kantons Thurgau** [*Vendi i kontaktit Gjuha dhe kultura e vendlindjes (HSK) i kantonit Thurgau*]  
Amt für Volksschule  
Spannerstrasse 31, 8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 58 14  
priska.reichmuth@tg.ch  
www.av.tg.ch
- ▶ [41] **Amt für Mittel- und Hochschulen des Kantons Thurgau** [*Seksioni për shkollat e mesme dhe të larta i kantonit Thurgau*]  
Grabenstrasse 11  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 58 30  
amh@tg.ch  
www.amh.tg.ch
- ▶ [42] **Amt für Mittel- und Hochschulen des Kantons Thurgau- Abteilung Ausbildungsbeiträge** ([*Seksioni për shkollat e mesme dhe të larta i kantoni Thurgau – Dega për kontributet e kualifikimit*])  
Grabenstrasse 11  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 58 38  
amh@tg.ch  
www.stipendien.tg.ch
- ▶ [43] **Thurgauisch-Schaffhauserisch-Maturitätsschule für Erwachsene** [*Shkolla e maturës Thurgauiane-Schaffhausiane për të rritur*]  
Neuhauserstrasse 7  
8500 Frauenfeld  
Tel. 058 345 51 00  
administration@tsme.ch  
www.tsme.ch
- ▶ [44] **Fachstelle Berufsabschluss für Erwachsene (BAE)** [*Vendi i specializuar për përfundimin e profesionit për të rritur (BAE)*]  
Amt für Berufsbildung und Berufsberatung  
Grabenstrasse 5  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 59 55  
bae@tg.ch, www.abb.tg.ch
- ▶ [45] **Amt für Umwelt des Kantons Thurgau** [*Seksioni për mjedisin i kantonit Thurgau*]  
Verwaltungsgebäude  
Promenadenstrasse 8  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 51 51  
umwelt.afu@tg.ch  
www.umwelt.tg.ch
- ▶ [46] **Kulturamt Thurgau** [*Seksioni i kulturës Thurgau*]  
Grabenstrasse 11  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 73 73  
kulturamt@tg.ch  
www.kulturamt.tg.ch
- ▶ [47] **Sportamt Thurgau** [*Seksioni i sportit Thurgau*]  
Zürcherstrasse 177  
8510 Frauenfeld  
Tel. 058 345 60 00  
sportamt@tg.ch  
www.sportamt.tg.ch
- ▶ [48] **Thurgau Tourismus** [*Turizmi Thurgau*]  
Friedrichshafenerstrasse 55a  
8590 Romanshorn  
Tel. 071 531 01 31  
info@thurgau-bodensee.ch  
www.thurgau-bodensee.ch
- ▶ [49] **Benevol Thurgau** [*Benevol Thurgau*]  
Freiwilligenzentrum  
Freiestrasse 10  
8570 Weinfelden  
Tel. 071 622 30 30  
info@benevol-thurgau.ch  
www.benevol-thurgau.ch
- ▶ [50] **HEKS -Hilfswerk der Evangelischen Kirchen Schweiz** [*HEKS -Organizata bamirëse e kishës evangelike të Zvicrës*]  
Regionalstelle Ostschweiz  
Weinfelderstrasse 11  
8580 Amriswil  
Tel. 071 410 16 84  
heks\_ostschweiz@heks.ch  
www.heks.ch

► [51] **Politische Parteien im Kanton Thurgau** *[Parti politike në kantonin Thurgau]*

► Christlichdemokratische Volkspartei (CVP)

-*[Partia Popullore Demokratiane (CVP)]*

[www.cvp-thurgau.ch](http://www.cvp-thurgau.ch)

► Sozialdemokratische Partei (SP)

-*[Partia Socialdemokrate (SP)]*

[www.spthurgau.ch](http://www.spthurgau.ch)

► Freisinnig-Demokratische Partei (FDP)

-*[Partia Demokratike Freisinnig (FDP)]*

[www.fdp-tg.ch](http://www.fdp-tg.ch)

► Schweizerische Volkspartei (SVP)

-*[Partia Popullore Zvicerane (SVP)]*

[www.svp-thurgau.ch](http://www.svp-thurgau.ch)

► Bürgerliche Demokratische Partei Schweiz (BDP)

-*[Partia Demokratike Qytetare Zvicër (BDP)]*

[www.bdp.info/tg](http://www.bdp.info/tg)

► Die Grünen

-*[Të Gjelbrit]*

[www.gruene-tg.ch](http://www.gruene-tg.ch)

► Grünliberale Partei (GLP)

-*[Partia Liberale e Gjelbër (GLP)]*

[www.tg.grunliberale.ch](http://www.tg.grunliberale.ch)

► Eidgenössisch-Demokratische Union

-*[Bashkimi Demokratik Konfederativ (EDU)]*

[www.edu-tg.ch](http://www.edu-tg.ch)

► Evangelische Volkspartei (EVP)

-*[Partia Popullore Evangjeliste (EVP)]*

[www.evp-thurgau.ch](http://www.evp-thurgau.ch)

## **Botuesja dhe grafika**

Zyra e migracionit e kantonit Thurgau  
Vendi i specializuar për integrimin

## **Printimi**

Ströbele Kommunikation, Romanshorn

## **Fotografi**

Kancelaria shtetërore e kantonit Thurgau  
Turizmi Thurgau  
[Pixabay.com](http://Pixabay.com)

# Numra për raste emergjente për Zvicrën

<b>Emergenca e përgjithshme</b> (edhe me kartë të huaj SIM) .....	112
<b>Policia</b> .....	117
<b>Zjarrfikëset</b> (zjarr, ujë, gaz) .....	118
<b>Saniteti/Ambulanca</b> .....	144
<b>Dora e zgjatur</b> (Gjendje emergjente psikike) .....	143
<b>Centrali i informacioneve toksikologjike</b> (Helmim) .....	145
<b>Telefoni emergjent për fëmijë dhe të rinj:</b> .....	147

## **Në një situatë emergjente:**

- ▶ Qëndroni të qetë.
- ▶ Identifikoni rreziqet.
- ▶ Çoni veten tuaj në siguri.
- ▶ Njoftoni forcat e shpëtimit.
- ▶ Jepni ndihmën e parë.